



QERSHOR 2025

Liria e mediave ne Maqedoninë e Veriut

Raport Hije

Metamorphosis Foundation

Osservatorio Balcani Caucaso Transeuropa

Raporti hije dhe rekomandimet e parashtruara janë hartuar në kuadër të Reagimit të Shpejtë për Lirinë e Medias, një mekanizëm në shkallë evropiane që gjurmon, monitoron dhe reagon ndaj shkeljeve të lirisë së shtypit dhe mediave në vendet anëtare të BE-së dhe vendet kandidate. Bazohet gjithashtu në aktivitete hulumtimi dhe advokimi të mbështetura nga projekti “Advokacia Mbarëkombëtare për Lirinë e Informimit në Ballkanin Perëndimor – ATLIB 2”, bashkëfinancuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar e Italisë.

Shkruar nga:



Me mbështetjen e:



co-funded by



Ministero degli Affari Esteri
e della Cooperazione Internazionale

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	1
Konteksti i Vendit	2
1. Liria e Medias në Maqedoninë e Veriut: një hyrje	4
1.1. Përmbledhje: përparimet dhe sfidat e vazhdueshme	4
1.2. Tregu i medias: fragmentimi, presionet ekonomike dhe pronësia	5
1.3. Financimii medias:reklamat, fondetshtetërore dhepavarësia	7
1.4. Besimi në media, disinformimi dhe edukimi mediatik	10
Rekomandime	12
2. Legjislacioni dhe Rregullimi i Medias	13
2.1. Korniza ligjore bazë	13
2.2. Organet rregullatore dhe vetë-rregullatore	14
2.3. Hendeku në rregullimim e mediave online	16
2.4. Reklamat shtetërore dhe rregullimi i fushatave zgjedhore	17
2.5. Përputhshmëria me standardet e BE-së dhe reformat në zbatim	18
Seksioni 2 - Procesi i integritimit në BE	19
2.5.1. Legjislacioni i medias në Maqedoninë e Veriut dhe Akti i Shërbimeve Digjitale i BE-së	20
2.6. Mbrojtja e të drejtave të autorit	22
Rekomandime	23
3. Siguria e gazetarëve	24
3.1. Përmbledhje mbi sigurisë e mjedisit mediatik	24
3.2. Kërcënimet fizike dhe psikologjike	25
3.3. Ngacmimet online dhe siguria digjitale	25
3.4. Korniza ligjore dhe përgjigjja institucionale	26
3.5. Kushtet e punës dhe presionet ekonomike	27
3.6. Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP)	28
Rekomandime	30
4. Disinformimidhe ndikimii huaj	31
4.1. Panoramë e disinformimit	31
4.2. Narrativat kryesore dhe Manipulimi i Informacionit nga Aktorë të Huaj (MIAH)	32
4.3. Aktorët dhe kanalet	33
4.4. Përgjigjja institucionale dhe sfidat	34
4.5. Siguria kibernetike dhe kërcënimet e ardhshme	34
Rekomandime	35
Lista e intervistave	36

Hyrje

Rrugëtimi evropian i Maqedonisë së Veriut filloi në vitin 2005, kur Vendi iu dha statusi i kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). Si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, Maqedonisë së Veriut i kërkohet të harmonizojë legjislacionin me *acquis communautaire* të BE-së, që përfshin një grup normash dhe standardesh për qeverisje demokratike të qëndrueshme dhe funksionale.

Nga 35 kapitujt negociues, kapitulli 23 dhe kapitulli 24 trajtojnë çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me respektimin e shtetit të së drejtës, përfshirë të drejtat themelore, pavarësinë e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe ekuilibrat demokratikë të pushteteve.¹ Ndër këto, liria dhe pavarësia e medias dallohen si elemente thelbësore për të garantuar stabilitetin demokratik të Vendi.

Gjendja e lirisë së medias në Maqedoninë e Veriut paraqet një panoramë të përzier. Pavarësisht uljes së dhunës ndaj gazetarëve dhe përparimit të bërë përmes reformave legjislative drejt standardeve evropiane, vendi ende përballet me sfida të konsiderueshme. Këto përfshijnë: disinformimin, nivelet e ulëta të profesionalizmit gazetaresk, veçanërisht në mediat online, presionet politike dhe ekonomike, kuadrin e dobët rregullator, si dhe rënien e besimit të publikut. Më tej, retorika negative e disa zyrtarëve publikë dhe ndërhyrjet e huaja kontribuojnë gjithashtu në krijimin e një mjedisi mediatik të brishtë.

Si vend kandidat për anëtarësim, Maqedonia e Veriut i nënshtrohet një shqyrtimi vjetor të progresit të reformave. Çdo vit, progresi raporti i Komisionit Evropian vlerëson shkallën e përgatitjes dhe përafrimit të vendit me standardet e BE-së, përfshirë edhe lirinë e medias.

Prej vitit 2024, Maqedonia e Veriut dhe vendet e tjera kandidate janë përfshirë gjithashtu në Raportin Vjetor mbi Shtetin e së Drejtës të BE-së, një mekanizëm që zbatohet prej vitit 2020 për të monitoruar zhvillimet dhe rreziqet e lidhura me shtetin e së drejtës në të gjitha shtetet anëtare. Raporti mbulon katër fusha kryesore: 1) sistemin e drejtësisë, 2) kuadrin kundër korrupsionit, 3) lirinë dhe pluralizmin e medias, dhe 4) ekuilibrat institucionalë të pushteteve. Prej vitit 2023, Komisioni ka hartuar gjithashtu rekomandime specifike për çdo vend, duke u kërkuar autoriteteve kombëtare të trajtojnë dhe zgjidhin sa më shpejtë problemet e identifikuar.

¹ Kapitulli përkatës i *acquis*

Raporti mbi Shtetin e së Drejtës për vendet kandidate plotëson raportet tradicionale vjetore të Komisionit Evropian, të cilat publikohen përgjithësisht në fund të vitit.

Ky raport hije ofron një panoramë të përditësuar të peizazhit mediatik në Maqedoninë e Veriut. Ai nxjerr në pah si zhvillimet pozitive, ashtu edhe sfidat e përhershme ose që kanë filluar të shfaqen. Raportipërfshin gjithashtunjë sërë rekomandimesh për autoritetet kombëtare dhe aktorët e BE-së, duke u bërë thirrje të ndërmarrin veprime vendimtare për të mbrojtur lirinë e medias në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Konteksti i Vendi

Sistemi politik dhe demografia

Maqedonia e Veriut është një Republikë kushtetuese me sistem demokratik parlamentar. Kushtetuta njeh si të drejtat individuale të të gjithë qytetarëve, ashtu edhe të drejtat kolektive të grupeve të caktuara etno-kulturore që jetojnë brenda kufijve të saj.

Vendi karakterizohet nga një përbërje etnike multikulturore dhe komplekse. Sipas censusit të vitit 2021, në Maqedoninë e Veriut jetojnë 1,836,713 banorë. Grupi më i madh etnik janë maqedonasit, të cilët përbëjnë 58.44% të popullsisë. Shqiptarët etnikë përbëjnë grupin e dytë më të madh me 24.30%. Komunitete të tjera të rëndësishme janë turqit (3.86%), romët (2.53%), serbët (1.30%), boshnjakët (0.87%) dhe vllahët (0.47%), ndërsa një përqindje e vogël i përket etnive të tjera (0.26%). Vlen të theksohet se regjistrimi i vitit 2021 u shoqërua me polemika me natyrë politike, të cilat sollën bojkotin e disa palëve. Rrjedhimisht, për 7.2% të popullsisë nuk njihet përkatësia etnike pasi të dhënat u morën nga burime administrative.²

Maqedonishtja është gjuha zyrtare në të gjithë territorin. Gjuha shqipe mban gjithashtu statusin e gjuhës zyrtare në nivel institucional qendror dhe është bashkë-zyrtare në kryeqytet (Shkup), si dhe në 25 nga 80 bashkitë e Vendi, si shenjë e përqindjes së lartë të popullsisë shqiptare.

² Censusi i Popullsisë dhe Banesave i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2021

Situata ekonomike

Ekonomia e Maqedonisë së Veriut përballet me sfida të mëdha, të shkaktuara në masë të madhe nga probleme shoqërore dhe politike, si nivelet e larta të korrupsionit, shqetësimet e vazhdueshme mbi sundimin e ligjit dhe mungesa e efikasitetit të administratës shtetërore. Tendencat e fundit të inflacionit kanë ndikuar negativisht në standardet e jetesës dhe kanë rritur nivelet e varfërisë. Sipas Bankës Botërore, rritja ekonomike për vitin 2023 ishte modeste dhe nën potencial, konkretisht në nivelin 1.8. Norma e papunësisë luhatej mes 12–13%. PBB-ja për frymë në vitin 2023 ishte rreth 7,480 euro, ndërsa paga mesatare mujore 595 euro, ndër më të ulëtat në rajon.

Situata politike dhe procesi i anëtarësimit në BE

Spektri politik mbetet thellësisht i polarizuar, i dominuar nga përçarje të qarta në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE. Një ndër çështjet më të kontestuara vazhdon të mbetet kushti i vendosur nga Bullgaria fqinje dhe i përfshirë në kornizën negociuese të BE-së, që kërkon përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e Kushtetutës si parakusht për ecurinë e procesit të anëtarësimit. Pavarësisht kundërshtive të theksuara dhe polemikave, aktorët ndërkombëtarë inkurajuan qeverinë për ta përmbushur këtë kërkesë. Megjithatë, ndryshimet kushtetuese nuk u miratuan për shkak të mungesës së konsensusit politik, veçanërisht nga ish-opozita, tani në pushtet, partia VMRO-DPMNE, si dhe për shkak të mbështetjes së ulët të popullësisë (rreth 24% sipas sondazheve)³.

Korrupsioni sistematik mbetet një problem kritik, me ndikim në nivelin jashtëzakonisht të ulët të besimit të publikut ndaj institucioneve politike dhe gjyqësore, siç theksohet nga anketat e Institutit Republikan Ndërkombëtar (IRI)⁴. Kjo situatë përbënte sfondin e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të mbajtura në maj 2024, të cilat sollën fitoren e partisë së qendrës së djathtë VMRO-DPMNE, e cila formoi një koalicion qeverisës të ri me koalicionin shqiptar VLEN. Ndasitë politike të vazhdueshme dhe çështja e pazgjidhur kushtetuese lidhur me anëtarësimin në BE vazhdojnë të përcaktojnë trajektoren politike të vendit.

³ 82% e maqedonasve dhe 11.3% e shqiptarëve janë kundër ndryshimeve kushtetuese për përfshirjen e bullgarëve në Kushtetutë. Burimi: 360 Degrees, bazuar në Detektor and Institute for Political Research, konsultuar më 5.5.2025. <https://360stepeni.mk/protiv-ustavni-izmeni-se-82-od-makedonsite-i-11-3-od-albantsite/>

⁴ Anketa Kombëtare e Maqedonisë së Veriut | Prill – Maj 2023

https://www.iri.org/ep-content/uploads/2023/07/IRI-N.Macedonia-Apr-May_2023_Poll.pdf

1. Liria e medias në Maqedoninë e Veriut: një hyrje

1.1 Përmbledhje: përparimi dhe sfidat e përherëshme

Maqedonia e Veriut paraqet një tablo komplekse sa i përket lirisë së medias. Renditjet ndërkombëtare, si Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit i hartuar nga Reporterë pa Kufij (Reporters Without Borders), e vendosin vendin në një nivel mesatar në shkallë globale, në vendin e 42-të nga 180 shtete në vitin 2025, në rënie me nga vendi i 36-të që mbante në vitin 2024. Ky pozicion pasqyron një përparim në krahasim me vitet e shkuara, por njëherazi vë në dukje edhe sfida që mbeten ende të pranishme⁵. Monitori i Pluralizmit të Medias (Media Pluralism Monitor, MPM) 2024 vlerëson nivelin e përgjithshëm të rrezikut në fushën e "Mbrotjes Themelore" si mesatar (35%), duke shënuar një rritje të lehtë të rrezikut në krahasim me vitin e mëparshëm.⁶

Edhe pse gazetarët sot nuk operojnë përgjithësisht në një mjedis haptazi armiqësor si në të kaluarën, vështirësi domethënëse e pengojnë zhvillimin e një sektori mediatik vërtet të pavarur, pluralist dhe të qëndrueshëm, i aftë t'i shërbejë tërësisht interesit publik dhe të forcojë demokracinë. Siç theksoi një profesionist i intervistuar për këtë raport: "Liria e medias është një nga treguesit më të fortë të nivelit të përgjithshëm të lirisë në një Vend"⁷.

Vendi ka bërë përparime në përafrimin e disa pjesëve të kuadrit ligjor me standardet evropiane dhe është shënuar një rënie e sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Megjithatë, çështje si disinformimi i përhapur, nivele të ndryshme profesionalizmi, qëndrimet problematike të disa zyrtarëve qeveritarë ndaj gazetarëve, presionet politike, pasiguria ekonomike dhe boshllëqet në rregullim vazhdojnë të hedhin hije mbi peizazhin mediatik dhe të kontribuojnë në nivelin e ulët të besimit publik. Siç vëren një raport, pavarësisht një "klime socio-politike të favorshme për punëne medias, disinformimi dhe niveli i ulët profesional, veçanërisht online, e ulin besimin te mediat"⁸.

⁵ ReportersWithoutBorders.(2025).2025WorldPressFreedomIndex. <https://rsf.org/en/country/north-macedonia>

⁶ Micevski, I., & Trpevska, S. (2024, qershor). "Monitorimi i Pluralizmit të Medias në Epokën Digjitale: Zbatimi i Monitorit të Pluralizmit të Medias në Shtetet Anëtare të BE-së dhe Vendet Kandidate në vitin 2023 – Raport Kombëtar: Republika e Maqedonisë së Veriut. Instituti Universitar Evropian, Qendra për Pluralizmin dhe Lirinë e Medias. (Në vijim: Raporti MPM 2024) <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/d66622e8-4fb4-11ef-acbc-01aa75ed71a1>

⁷ Intervista 4.

⁸ Nikodinoska, V., & Chausidis, T. (2025). Tregu i kufizuar medik, standardet e ulëta etike, nevojapër legjislacione efektiv: Eardhmja e medias në Maqedoninë e Veriut – Faktet dhe Tendencat. SEENPM, Mediacentar Sarajevo, Instituti i Mediave i Maqedonisë, Instituti i Paqes. <https://futureofmedia.seenpm.org/ep-content/uploads/2025/03/Ourmedia-North-Macedonia-EN.pdf>

Manipulimi dhe Ndërhyrjet e Huaja në Informim (MNHI) paraqet gjithashtu një sfidë të konsiderueshme për mjedisin mediatik, duke shfrytëzuar dobësitë e brendshme si mungesa e profesionalizmit në media dhe trazirat politike.

Liria e shprehjes garantohet me Kushtetutë dhe censura është e ndaluar⁹. Megjithatë, realiteti me të cilin përballen gazetarët dhe mediat shpesh nuk përkon me të tilla ideale kushtetuese. Mjedisi i përgjithshëm mbetet më i favorshëm për lirinë e shtypit në krahasim me periudhat e mëparshme, por ky progres shpesh përshkruhet si i brishtë ose si “në terren të pasigurtë”¹⁰.

Kërcënimet dhe presionet, veçanërisht nga figura politike, interesat e biznesit dhe kanalet online, mbeten shqetësim, duke ndikuar në aftësinë e gazetarëve për të punuar lirshëm dhe me qasje kritike.

Polarizimi i lartë politik ndikon në rritjen e presionit mbi median, me partitë kryesore që herë pas here mbështetin sisteme mediatike paralele me ndikimin politik dhe ekonomik. Më tej, mungesa e besimit publik tek institucionet, përfshirë median, e nxitur nga nivele të larta të perceptimit të korrupsionit dhe mungesës së efikasitetit institucional, minon rolin thelbësor të medias si instrument mbikëqyrës dhe si një nga shtyllat e një shoqërie demokratike.

1.2 Tregu i medias: fragmentimi, presioni ekonomik dhe pronësia

Tregu i medias në Maqedoninë e Veriut karakterizohet nga një fragmentim i konsiderueshëm, veçanërisht me përhapjen e platformave online krahas mediave tradicionale. Numri i kanaleve mediatike nuk përputhet me dimensionet e vendit dhe potencialin ekonomik të tregut. Monitori i Pluralizmit të Medias 2024 thekson këtë fragmentim në sektorët e televizionit, radios, shtypit dhe mediave online¹¹.

Megjithatë, numri i transmetuesve tradicionalë (TV dhe radio) është në rënie, shpesh për shkak të vështirësive financiare. Kjo rënie është veçanërisht edallueshme në nivel lokal dhe rajonal, ku mediat e pakta ende në aktivitet funksionojnë në kushte të vështira ekonomike, duke çuar në shfaqjen e të ashtuquajturave “shkretëtira mediatike”. Nënzhvillimi i tregut mediatik lokal dhe rajonal, i gërshetuar me mungesë mbulim të çështjeve lokale nga televizioni, radioja dhe mediat kombëtare, përbën një kërcënim serioz për pluralizmin mediatik.

⁹Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Neni 16. <https://www.slvesnik.com.mk/content/pdf/USTAV-eng.pdf>

¹⁰ Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (2023). Liria e medias në Maqedoninë e Veriut: Progres i brishtë – Raporti i Misionit të Verifikimit të Fakteve mbi Lirinë e Medias. <https://znm.org.mk/en/progress-on-glass-legs-a-report-from-the-mission-for-assessing-the-state-of-freedom-of-the-media-in-macedonia/>

¹¹ Micevski, I., & Trpevska, S. (2024, June). Monitorimi i Pluralizmit Mediatik në Epokën Digjitale: Zbatimi i Monitorit të Pluralizmit të Mediave në Shtetet Anëtare të BE-së dhe Vendet kandidatë për vitin 2023 – Raporti i Vendi: Republika e Maqedonisë së Veriut. European University Institute, Qendra për Pluralizëm Mediatik dhe Liri të Medias <https://cadmus.eui.eu/server/api/core/bitstreams/ed9fd83e-1455-5e49-b698-ae3bf0999e2a/content>

Polarizimi i fortë politik ndikon në këtë peizazh, me sinjale se partitë më të mëdha mbështesin sisteme mediatike paralele nën ndikimin e tyre.

Transmetuesi publik (MRT) përballlet me presione të vazhdueshme politike dhe paqëndrueshmëri financiare, situatë që minon mundësinë për të shërbyer si kanal që ofron përmbajtje të paanshme në favor të interesit publik. Financimi i pamjaftueshëm sjell si pasojë paga të ulëta dhe kushte të papërshtatshme pune, duke shkaktuar mungesë në profesionalizëm dhe përmbajtje me cilësi më të ulët. Programet e MRT-së kufizohen kryesisht në raportimin bazik të lajmeve, mungesë të analizës kritike dhe mangësi në diversitet apo pluralizëm. Për të kompensuar boshllëqet në raportimin e thelluar, MRT ka bashkëpunuar me organizata mediatike jofitimprurëse, si Laboratori i Gazetarisë Investigative (Investigative Reporting Lab) dhe 360°, për të bashkëprodhuar aktivitete mediatike hulumtuese.

Potenciali i kufizuar ekonomik nuk mund të garantojë zhvillimin e qëndrueshëm në fushën audiovizuale dhe as të sigurojë vazhdimësinë e shumë mediave. Vështirësitë financiare shkaktojnë mangësi në staf profesionist, diversitet të kufizuar të programeve, prodhim të pamjaftueshëm vendor dhe vështirësi në ruajtjen e standardeve të larta profesionale. Sektori i medias së shkruar është ai që përballlet me sfidat më të mëdha, me tirazhe tejet të ulëta për pak të përditshmet e mbetura.

Gjatë zgjedhjeve të vitit 2024, 249 media online (porta-le) u regjistruan për të marrë reklama politike me pagesë, duke nxjerrë në pah rritjen e rolit të tyre në treg, por njëkohësisht duke ngritur shqetësime në lidhje me transparencën, pasi shumë prej këtyre mediave nuk mund të identifikoheshin qartë ose ishin krijuar rishtazi¹².

Numri i mediave online po rritet me shpejtësi. Megjithatë, siç vuri në dukje një nga të intervistuarit, “pavarësisht numrit të madh të mediave, nuk mund të thuhet se kemi një peizazh mediatik me të vërtetë pluralist. Kjo kryesisht sepse pjesa dërrmuese e mediave fokusohet tek politika kombëtare, shpesh duke anashkaluar mbulimin e lajmeve lokale dhe temave të rëndësishme si çështjet sociale apo mjedisi”¹³. Për më tepër, numri i lartë i mediave online e përkeqëson fragmentimin e tregut dhe ngre shqetësime për profesionalizmin, qëndrueshmërinë dhe përhapjen e disinformimit, sidomos në mungesë të dispozitave ligjore.

Megjithatë, ndryshimet e reja në ligjin ekzistues për mediat, të miratuara në mars 2024, përfshirë krijimin e një regjistri zyrtar për mediat online, përbëjnë një hap përpara në adresimin e këtyre çështjeve¹⁴. Mediat jofitimprurëse mbeten një ndër segmentet më të nënzhvilluara të peizazhit mediatik.

¹² IFES & Metamorphosis Foundation. (2024, December). Drejt Portaleve gjithëpërfshirëse dhe reklamave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut. https://metamorphosis.org.mk/en/izdanija_arhiva/towards-inclusive-internet-portals-and-election-advertising-in-north-macedonia/

¹³ Intervista 5.

¹⁴ Vlerësimi i Reformave të Ligjit për Mediat në Maqedoninë e Veriut – Një hap i pjesshëm drejt standardeve evropiane. Metamorphosis Foundation 2025 <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/themes/metamorphosis/download.php?id=45569>

Transparenca e pronësisë së medias është relativisht e lartë për transmetuesit dhe median e shkruar, për shkak të detyrimit ligjor për të raportuar strukturat e pronësisë pranë Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio Vizuale (ASHMAA), e cila është përgjegjëse për publikimin e këtyre të dhënave.

Megjithatë, e njëjta transparencë nuk zbatohet për mediat online. MPM 2024 e vlerëson “Transparencën e pronësisë së medias” në nivel rreziku mesatar (48%), kryesisht për shkak të nënrregullimit të sektorit online, duke theksuar një rrezik të lartë (75%) lidhur me informacionin e disponueshëm specifikisht në fushën digjitale¹⁵. Pritet që kjo situatë të përmirësohet me miratimin e ndryshimeve ligjore që parashikojnë krijimin e një regjistri për mediat online.

Në çdo rast, shqetësimi mbetet për struktura të fshehta të pronësisë dhe lidhjet e mundshme midis mediave (veçanërisht atyre online dhe portaleve) me interesa politike apo biznesi, të cilat mund të komprometojnë pavarësinë redaksionale dhe të krijojnë konkurrencë të pandershme në treg.

Dispozitat ligjore ekzistuese mbi përqendrimin e pronësisë së medias konsiderohen të vjetruara nga disa ekspertë dhe të papërshtatshme për mjedisin digjital, duke penguar potencialisht konsolidimin e nevojshëm të tregut.

1.3 Financimi i medias: reklamat, fondet shtetërore dhe pavarësia

Financimi i mediave mbështetet kryesisht te të ardhurat nga reklamat. Megjithatë, tregu i reklamave (i vlerësuar rreth 40 milionë euronë vit) mbetet relativisht i kufizuar dhe statik. Në tregun tejet të fragmentuar të transmetimeve, vetëm disa televizione kombëtare arrijnë të përthithin një pjesë të konsiderueshme të ardhurave nga reklamat (të vlerësuar rreth 20 milionë euro në vit për transmetuesit). Kanalet kryesore televizive shpesh përballen me presione ekonomike të lidhura me strukturat e pronësisë, duke qenë se disa pronarë janë drejtpërdrejt të lidhur ose të afërt me parti politike dhe biznese të mëdha.

¹⁵ Micevski, I., & Trpevska, S. (2024, June). Monitorimi i Pluralizmit Mediatik në Epokën Digjitale: Zbatimi i Monitorit të Pluralizmit të Mediave në Shtetet Anëtare të BE-së dhe Vendet kandidatë për vitin 2023 – Raporti i Vendi: Republika e Maqedonisë së Veriut. European University Institute, Qendra për Pluralizëm Mediatik dhe Liri të Medias <https://cadmus.eui.eu/server/api/core/bitstreams/ed9fd83e-1455-5e49-b698-ae3bf0999e2a/content>

Edhe pse të dhëna të sakta mungojnë, përlogaritet se reklamat në median online janë në rritje, ndërsatë ardhurat ngareklamat në median e shkruar në rritje. MPM 2024 e vlerëson “qëndrueshmërinë e mediave” në rrezik të lartë (72%), një përkeqësim krahasuar me vitin e kaluar, duke theksuar prirjet epafavorshme në sigurimin e të ardhurave (sidomos për mediat lokale/rajonale) dhe rënie të nivelit të punësimit.

Financimi shtetëror po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, duke ngritur shqetësime serioze për pavarësinë e mediave dhe potencialin për klientelizëm. Mekanizmat e financimit shtetëror shpesh kritikohen si të kufizuara dhe jotransparente, duke bërë që mediat e pavarura të mbështeten kryesisht të donatorët. Ndërkohë që subvencionet direkte janë të kufizuara (kryesisht shuma të vogla dhe në rënie për shpërndarjen e mediave të shkruara), financimi indirekt nga shteti përmes reklamave politike me pagesë gjatë zgjedhjeve dhe, së fundmi, rivendosja e bazës ligjore për fushatatë “interesi publik” të financuara nga shteti, përfaqëson një burim të rëndësishëm të ardhurash për shumë media.

Buxheti i alokuar për reklamat politike gjatë zgjedhjeve është rritur ndjeshëm, duke arritur mbi 10 milionë euronë zgjedhjeve vitit 2024. Si rrjedhojë, në prag të zgjedhjeve është vërejtur një rritje e numrit të mediave online, të krijuara posaçërisht për të siguruar fonde të konsiderueshme nga buxheti i shtetit. Një mbivendosje problematike mes politikës dhe medias del në pah: partitë politike përdorin fondet shtetërore për të financuar fushatat e tyre, duke krijuar një sistem që nxit klientelizëm, korrupsion dhe ndikim të papërshtatshëm mbi median e pavarur. Në këtë situatë, reklamat politike përdoren për të ndikuar politikën redaksionale. As mediat dhe as politikanët nuk tregojnë vullnet për të reformuar këtë sistem: mediat përfitojnë financiarisht, ndërsa partitë fitojnë hapësirë për fushatë pa përdorur burimet e tyre. Mediat kryesore private, në veçanti, angazhohen në lobim të fuqishëm për të ruajtur rregullat aktuale të reklamave politike.

Sistemi i financimit shtetëror për reklamat zgjedhore, veçanërisht në mediat online dhe portale, konsiderohet unik dhe është kritikuar shpesh pasi favorizon partitë më të mëdha dhe të konsoliduara. Për shkak të mbikëqyrjes së pamjaftueshme, ai shpesh sjell përfitime për sipërmarrësitë lidhur me politikën më shumë se për mediat¹⁶.

¹⁶ IFES & Metamorphosis Foundation. (2025). Financimi i shtetit në Maqedoninë e Veriut: Për një sistem më të drejtë, më të fortë dhe më transparent. https://metamorphosis.org.mk/en/izdaniya_arhiva/state-funding-in-north-macedonia-making-the-system-fairer-stronger-and-more-transparent/

Vetëm portalet online përthithën një shumë të vlerësuar prej 811,013 eurosh nga fondet publike gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2024, duke përjashtuar këtu zgjedhjet presidenciale të zhvilluaranë tënjëjtën kohë. Totali ifondeve tëakorduara përmedian online për të dyja proceset zgjedhore (parlamentare dhe presidenciale) vlerësohet rreth 2 milionë euro. Me ndryshimet në ligjin për median, pritet që rregullimi i financimit të mediave gjatë fushatave zgjedhore të kalojënga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve te Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio Vizuale. Ky rregullator i ri për financimin e fushatave në median online, sipas raportimeve, do të kufizojë të drejtën për të aplikuar për fonde vetëm për ato media që janë pjesë e regjistrit zyrtar të portaleve online.

Vendimi i vitit 2024 për të lejuar sërish mundësinë për zhvillimin e fushatave të financuar nga shteti, duke përmbysur ndalimin e vendosur prej vitit 2017, u prit me kritika të forta nga organizatat e medias dhe vëzhguesit ndërkombëtarë. Ky hap u konsiderua si një rrezik për pavarësinë e mediave dhe një mekanizëm që mund të nxitë ndikim politik dhe korrupsion. Shoqatat e gazetarëve dhe ekspertët e politikave të medias u shprehën qartësisht kundër heqjes së ndalimit, duke paralajmëruar se ky vendim “krijon një mekanizëm financiar të ndërlikuar për kalimin e ‘legalizuar’ të fondeve publike drejt të gjitha mediave private audiovizuale, duke i bërë ato të varura drejtpërdrejt nga autoritetet qendrore dhe lokale¹⁷”.

Një propozim alternativ, krijimi i një fondi të pavarur për pluralizmin mediatik, me qëllim mbështetjen e gazetarisë cilësore në funksion të interesit publik bazuar në kritere objektive, është advokuar nga organizata profesionale, por ende nuk është miratuar nga qeveria.

Mediet hulumtuese, joqeveritare dhe komunitare mbështeten kryesisht te grantet nga donatorët e huaj, të cilat shërbejnë si një burim jetik për gazetarinë në funksion të interesit publik. Pak të mbështetje, është e jetëveshtirë që media të pavarurat të mbijetojnë në treg. Donatorët kryesorë përfshijnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe disa ambasada evropiane, si ato të Holandës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Gjermanisë.

¹⁷ Spirovski, M. (2024). Maqedonia e Veriut – Treguesit për Nivelin e Lirisë së Medias dhe Indeksii Sigurisë së Gazetarëve 2023. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë.
https://znm.org.mk/ep-content/uploads/2024/11/MK-ENG-2024_FINAL-1.pdf

Megjithatë, financimi ndërkombëtar nga donatorët nuk ofron zgjidhje afatgjatë për qëndrueshmërinë e sektorit, siç dëshmohet nga ndërprerja e projekteve të USAID-it, e cila pati efekt negativ domethënës mbi këto media. Siç u shpreh një i intervistuar: “në plan afatgjatë, mbështetja vetëm te donatorët nuk është zgjidhje e qëndrueshme. Mediat duhet të bëhen të vetëqëndrueshme dhe të mbështeten nga tregu mediatik. Megjithatë, tregu këtu është shumë i dobët dhe situata bëhet edhe më komplekse për shkak të ndikimit të aktorëve politikë dhe ekonomikë”¹⁸.

Në përmbledhje, mungesa e stabilitetit financiar mbetet kërcënimi kryesor për pavarësinë redaksionale dhe pluralizmin mediatik në vend.

1.4 Besimi në media, disinformimi dhe edukimi mediatik

Besimi i publikut tek mediat në Maqedoninë e Veriut është përgjithësisht i ulët, duke reflektuar besimin e ulët edhe ndaj institucioneve të tjera shtetërore¹⁹. Disinformimi i gjerë dhe standardet jo të qëndrueshme profesionale identifikohen si faktorë kyç që kontribuojnë në këtë rënie të besimit.

Ndërsa televizioni mbetet burimi më i përdorur i informacionit për popullatën e përgjithshme, brezat e rinj drejtohen gjithnjë e më shpesh tek mediat online dhe rrjetet sociale. Megjithatë, nivelet e besimit janë veçanërisht të ulëta për mediat online dhe rrjetet sociale, të cilat shpesh perceptohen si burime informacioni me cilësi të ulët, propagande dhe gjuhë urrejtjeje.

Qytetarët përmendin ndikimin politik mbi politikën editoriale dhe përhapjen e disinformimit si arsye kryesore për mungesën e besimit²⁰. Hapësira informative është e ndjeshme ndaj ndikimeve të huaja, me narrativa që shpesh mbërrijnë nga rajoni (p.sh. Serbia) ose nga media të kontrolluara nga shteti rus²¹.

¹⁸ Intervista 3.

¹⁹ Raporti i Shtetit të së Drejtës 2024: Kapitulli mbi situatën e shtetit të së drejtës në Maqedoninë e Veriut (SëD(2024) 830 final). https://commission.europa.eu/document/download/e7197a43-7f00-4eac-b02d-818ac71345f0_en?filename=61_1_58090_coun_chap_northmacedonia_nm.pdf.

²⁰ Nikodinoska, V., & Chausidis, T. (2025). Tregu i kufizuar medik, standarde të ulëta etike, nevoja për legjislacion efektiv: E ardhmja e mediave në Maqedoninë e Veriut – Fakte dhe Tendencë. SEENPM, Mediacentar Sarajevo, Instituti i Mediave i Maqedonisë, Instituti i Paqes. fq. 28, ku citohet South East European Network for Professionalization of Media (2022).

²¹ Trojchanec, M., & Rizaov, G. (2024, September). Stabiliteti nën Kërcënim: MNHI në Maqedoninë e Veriut. Fondacioni Metamorphosis, IRI Beacon Project. <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/themes/metamorphosis/download.php?id=43953>.

Vlerësimi MPM 2024 e klasifikon “Edukimin mediatik” me rrezik mesatar (62%), duke theksuar se edukimi mediatik i popullatës mbetet një fushë me rrezik të lartë (75%) për shkak të mungesës së të dhënave dhe integritetit të pamjaftueshëm në arsimin formal dhe informal²²

Disinformimi dhe shkelja e standardeve etike janë veçanërisht të përhapura në hapësirën online. Rrjetet sociale dhe sfera digjitale lehtësojnë përhapjen e disinformimit dhe kërcënimeve kibernetike, të cilat herë pas here shkaktjnë sulme ndaj gazetarëve bazuar në gjini, etni ose besim fetar²³. Mungesa e rregullimit, transparencës (certifikatë pronësie, autorësia) dhe llogaridhënies kontribuon në këtë problem. Ndërsa organet vetë-rregulluese marrin një numër në rritje ankesash, kapaciteti i tyre për të adresuar përmasta e problemit, veçanërisht online, mbetet i kufizuar.

Duke pranuar këtë sfidë, përpjekjet për të promovuar edukimin mediatik kanë fituar përparësi. Edukimi mediatik është integruar në programin zyrtar të arsimit për shkollat fillore që nga viti 2021, dhe një rrjet organizatash të shoqërisë civile, mediash dhe institucioneve promovon aktivisht ndërgjegjësimin mbi edukimin mediatik në segmente të ndryshme të shoqërisë. Këto iniciativa janë thelbësore për të mbështetur rezistencën e qytetarëve ndaj disinformimit dhe për të inkurajuar një angazhim kritik me përmbajtjet mediatike. Megjithatë, të tilla iniciativa të edukimit mediatik financoheshin kryesisht nga USAID përmes një projekti të organizatës IREX, dhe pas janarit 2025 ato nuk zbatohen më.

¹⁸ Trojachanec, M., & Rizaov, G. (2024, September). Stabiliteti nën Kërcënim: MNHI në Maqedoninë e Veriut. Fondacioni Metamorphosis, IRI Beacon Project. <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/themes/metamorphosis/download.php?id=43953>.

²² Micevski, I., & Trpevska, S. (2024, qershor). Monitorimi i Pluralizmit të Mediave në Epokën Digjitale: Zbatimi i Monitorit të Pluralizmit të Mediave në Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet candidate në 2023 – Raporti i vendit: Republika e Maqedonisë së Veriut. European University Institute, Qendra për Pluralizëm dhe Liri të Mediave. fq. 13-14.

Rekomandime:

- Të garantohet qëndrueshmëria financiare e mediave për të promovuar një mjedis mediatik pluralist dhe të pavarur.
- Të krijohen mekanizma të qartë, transparentë dhe të monitorueshëm për ndarjen e financimeve publike drejt mediave, për të parandaluar rreziqet e korrupsionit dhe klientelizmit:
 - Të shfuqizohet dispozita aktuale në Kodin Zgjedhor që lejon reklamën politike të paguara, për të shmangur deformimet e tregut, konkurrencën zgjedhore jo të drejtë, punën jo profesionale dhe jo-etike të gazetarëve, korrupsionin dhe klientelizmin e përhapur.
 - Të ndalohet përdorimi i reklamave të sponsorizuara nga shteti në media. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet të përcaktohen dhe të zbatohen kritere më të rrepta për shpërndarjen e reklamave shtetërore, duke garantuar që financimi të jetë i kushtëzuar nga respektimi i standardeve etike gazetareske, të përmirësohet ndjeshëm transparenca në procesin e alokimit dhe të kërkohet që informacioni i detajuar mbi shpërndarjen e fondeve publike të jetë i aksesueshëm publikisht për konsultim.
 - Të krijohet një Fond i Pavarur për Pluralizmin e Mediave për të mbështetur qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit të mediave, për të promovuar gazetari me cilësi të lartë dhe për të përmirësuar kushtet e punës për profesionistët e medias.
- Të forcohet roli i Shërbimit Publik duke e mbrojtur atë nga ndikimi politik dhe duke siguruar burime të mjaftueshme financiare për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe kushteve të drejta të punës. Kjo do të përmirësonte gjithashtu profesionalizmin e përgjithshëm në këtë sektor.
- Të përditësohen rregulloret mbi pronësinë dhe përqëndrimin e mediave, duke përfshirë mediat digjitale dhe online, për të siguruar që kuadri ligjor të përparojë në përputhje me zhvillimin e mjedisit mediatik.
- Të promovohet pluralizmi mediatik në nivel lokal dhe rajonal, duke mbështetur një diversitet perspektivash dhe temash në mbulimin mediatik.

2. Legjislacioni dhe Rregullimi i Medias

Peizazhi mediatik në Maqedoninë e Veriut ndodhet në një moment kritik. Edhe pse janë bërë disa përparime, veçanërisht në krahasim me dekadën e kaluar, vazhdojnë të mbeten sfida të rëndësishme strukturore, ekonomike dhe rregullatore. Kapitujt e mëposhtëm do të shqyrtojnë më në hollësi kuadrin ligjor që rregullon mediat dhe çështjet urgjente që lidhen me sigurinë e gazetarëve, përfshirë shqetësimin në rritje për Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPPs). Kuptimi i këtyre fushave është i domosdoshëm për të përcaktuar rrugën drejt një mjedisi mediatik me të vërtetë të lirë, të pavarur, pluralist dhe të qëndrueshëm, i aftë të mbështesë aspiratat demokratike të vendit.

2.1 Korniza ligjore bazë

Ligjet kryesore që rregullojnë sektorin e mediave në Maqedoninë e Veriut janë Ligji për Mediat (LM) dhe Ligji për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).

LSHMAAV rregullon sektorin e transmetimit, duke përcaktuar detyrat, strukturën dhe funksionimin e rregullatorit kombëtar (AMSHAAV) dhe të transmetuesit publik (MRT).

Ligji për Mediat, i ndryshuar së fundmi në vitin 2025, trajton aspekte më të gjera, përfshirë përmbajtjen mediatike dhe përgjegjësitë e botuesve, megjithatë shtrirja e tij është e kufizuar, sidomos për sa i përket mediave online²⁴.

Ligje të tjera të rëndësishme përfshijnë Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ngjashme (LDADN), thelbësor për mbrojtjen e punës së gazetarëve²⁵, Ligjin i Përgjegjësisë Civile për Fyerje dhe Shpife (LPCFSH), i cili përcakton kuadrin për rastet e shpifjes kundër mediave, si dhe Kodi Zgjedhor, i cili përmban dispozita të diskutueshme lidhur me reklamat politike me pagesë.

²⁴ Metamorphosis Foundation. (2025). Position Paper: Vlerësimi i Reformave të Ligjit për Mediat në Maqedoninë e Veriut – Një hap i pjesshëm drejt standardeve evropiane. https://metamorphosis.org.mk/en/izdaniya_arhiva/evaluating-north-macedonias-media-law-reforms-a-partial-step-toward-european-standards/

²⁵ Pepeljugoski, V., Manasiev, A., & Janevska, E. (2023). Të Drejtat e Gazetarëve, Liria e Shprehjes dhe Pavarësia e Medias në Maqedoninë e Veriut – 2023 Raporti Metadata. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2024/01/EN-MetaData-Report-131223-web.pdf>

Ligji për Komunikimet Elektronike u jep të drejtë të gjithë ofruesve të shërbimeve telefonike dhe internetit të ruajnë metadatat e përdoruesve të tyre për një vit, pavarësisht nga Udhëzimi i BE-së për Ruajtjen e të Dhënave (2014). Metadatat përfshijnë të dhëna mbi kohën dhe personat me të cilët komunikojmë, formën e komunikimit, pajisjet e përdorura, vendndodhjet dhe lëvizjet me pajisjet e levizshme²⁶. Ndryshimet në Kodin Penal në vitin 2023 parashikojnë mbrojtje specifike për gazetarët, duke i trajtuar sulmet ndaj tyre në mënyrë të ngjashme me sulmet ndaj zyrtarëve²⁷.

2.2 Organet rregullatore dhe vetë-rregullatore

Agjencia për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) është organi i pavarur rregullator përgjegjës për sektorin e transmetimit. Detyrat e saj përfshijnë licencimin e transmetuesve, monitorimin dhe respektimin e rregullave, mbikëqyrjen e pronësisë dhe përqendrimit të mediave, si dhe mbajtjen e regjistrave të transmetuesve dhe mediave të shkruara. Me ndryshimet e fundit në Ligjin për Mediat, ASHMAA do të administrojë gjithashtu një regjistër të mediave online.

Edhe pse përgjithësisht e përmbush mandatin ligjor, pavarësia institucionale dhe financiare e Agjencisë përballen me sfida të shumta. Problemet lidhen me transferime të paplota nga buxheti i shtetit dhe vonesa të konsiderueshme në emërimet parlamentare për Këshillin e saj, të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar e që shpesh bllokohen për shkak të polarizimit politik²⁸. Në fund të janarit 2025, Komisioni Parlamentar për Zgjedhjet dhe Emërimet propozoi një listë kandidatësh për Këshillin e AAVMS. Megjithatë, përzgjedhja ngriti shqetësime serioze në komunitetin mediatik, pasi disa nga kandidatët e propozuar nuk përmbushin kriteret formale për anëtarësimin në Këshill, duke lënë të kuptohet se kishte pasur një marrëveshje të qartë politike pas emërimeve. Më 24 qershor 2025, më shumë se dy të tretat e deputetëve votuan për kandidatët e rinj të Këshillit.

²⁶ Danilovska Bajdevska, D. (2024). Drejt Zbatimit të Qëndrueshëm të Aktit për Shërbimet Digjitale në Ballkanin Perëndimor: Përmbledhje – Maqedonia e Veriut. Partners for Democratic Change Serbia. fq. 66.
https://metamorphosis.org.mk/en/izdaniya_arhiva/towards-a-feasible-implementation-of-the-digital-services-act-in-the-western-balkans/

²⁷ Komisioni Evropian, (2024) Raporti i Shtetit të Drejtës 2024: Kapitulli i vendit mbi situatën e shtetit të drejtës në Maqedoninë e Veriut (SWD(2024)). https://commission.europa.eu/document/download/e7197a43-7f00-4eac-b02d-818ac71345f0_en?filename=61_1_58090_coun_chap_northmacedonia_nm.pdf

²⁸ Komisioni Evropian, (2024) Raporti i Shtetit të Drejtës 2024: Kapitulli i vendit mbi situatën e shtetit të drejtës në Maqedoninë e Veriut (SWD(2024)). https://commission.europa.eu/document/download/e7197a43-7f00-4eac-b02d-818ac71345f0_en?filename=61_1_58090_coun_chap_northmacedonia_nm.pdf (2023). Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). (2023). Liria e medias në Maqedoninë e Veriut: Përparimi i brishtë – Raport i Misionit të Verifikimit të Fakteve mbi Lirinë e Shtypit. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2023/10/EN-Fact-Finding-PFM-Report-251023-web.pdf>

Përpara se të zhvillohej votimi, një nga bashkëbiseduesit tanë vuri në dukje: "Do të thoja se kandidatët e përzgjedhur janë skandalozë, pasi disa prej tyre nuk përmbushin as kërkesat bazë ligjore. Ata nuk përçojnë tek ne (komuniteti mediatik, shënim i redaktorit) besimin se janë individët e duhur për të shërbyer në bordin drejtues të një organi të pavarur rregullator të mediave. Nëse këta individë emërohen formalisht nga Parlamenti, garantohet ndikim politik i sigurt, që do të çojë në ulje të pavarësisë së mediave²⁹".

Përveç kësaj, amendiment e LSHMAAV në shkurt 2024 u kritikuan për dobësimin e rolit të Agjencisë si rregullator dhe tkurrjen e mandatit të saj, duke hequr kompetencën për të vendosur mbi rinovimin e licencave bazuar në kontributin për diversitetin dhe pluralizmin e programacionit. Siç theksoi një prej bashkëbiseduesve: "Sipas dispozitës së mëparshme, rregullatori i mediave duhej të vlerësonte kontributin e një transmetuesi në pluralizmin e peizazhit mediatik përpara vendimmarrjes për rinovimin e licencës. Tani, kjo kërkesë është hequr plotësisht. Me fjalë të tjera, tani rregullatori është i detyruar t'i rinovojë licencat, ndërsa mund ta refuzojë rinovimin vetëm në raste shumë specifike, si gjuhë e tepruar urrejtjeje ose nëse ka pasur më shumë se tre shkelje të të drejtave të të miturve"³⁰. Kjo ndryshim dobëson ndjeshëm rolin e rregullatorit të mediave në mbrojtjen e pluralizmit mediatik.

Vetë-rregullimi menaxhohet kryesisht nga Këshilli për Etikë në Media (KEMM) dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). KEMM, një organ me bazë vullnetare dhe që përfaqëson media të ndryshme, trajton ankesa lidhur me shkeljet e Kodit të Etikës Gazetareske. Ky këshill ka regjistruar një rritje të ankesave, veçanërisht për mediat online, në lidhje me gjuhën e urrejtjes, saktësinë dhe verifikimin e informacionit. Megjithatë, ka pasur raportime se KEMM është përballur me presion nga aktorë politikë dhe ekonomikë³¹. SHGM është shoqatë me profesionalitet të lartë që advokon për të drejtat e gazetarëve, monitoron sulmet, ofron ndihmë ligjore dhe nxit miratimin e reformave. Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SPGM) gjithashtu ka rol në mbrojtjen e të drejtave të punës.

²⁹ Intervista 5.

³⁰ Intervista 1.

³¹ Komisioni Evropian, (2024) Raporti i Shtetit të Së Drejtës 2024: Kapitulli i vendit mbisituatën e shtetit të së drejtës në Maqedoninë Veriut (SWD(2024)). https://commission.europa.eu/document/download/e7197a43-7f00-4eac-b02d-818ac71345f0_en?filename=61_1_58090_coun_chap_northmacedonia_nm.pdf

2.3 Hendeku në rregullimin e mediave online

Një mangësi e rëndësishme në kuadrin ligjor aktual është përjashtimi i mediave online nga përkufizimi kryesor i “medias” në Ligjin për Mediat. Ky përkufizim fokusohet tek formatet tradicionale (TV, radio, shtyp), duke lënë jashtë sferën digjitale, tashmë në zgjerim të shpejtë, përfshirë portalet e lajmeve dhe platformat e tjera online, të cilat mbeten kryesisht jashtë fushës së rregullimit specifik për media. Kjo ka krijuar një “zonë gri” që karakterizohet nga:

- **Mungesa e transparencës:** Nuk ka kërkesë ligjore për mediat online që të bëjnë publike strukturat apo certifikatat e pronësisë (impressum).
- **Status kontradiktor:** Mediat online trajtohen si media për qëllime të caktuara (p.sh. ndarja e fondeve shtetërore për reklamat zgjedhore), por nuk gëzojnë njohje ligjore në raste të tjera (p.sh. procedura gjyqësore, zbatimi i standardeve etike specifike për media).
- **Standarde profesionale:** Vështirësi në zbatimin e standardeve profesionale dhe etike, çka kontribuon në përhapjen e disinformimit dhe gjuhës së urrejtjes online. Ndërsa KEMM, mban një regjistër vullnetar (“Promedia”) për mediat profesionale online, respektimi i vendimeve etike shpesh mbetet i mangët, si nga anëtarët ashtu edhe nga mediat jo-anëtare³².

Amendimet e kohëve të fundit në Ligjin për Mediat synojnë ta adresojnë këtë hendek, duke përfshirë mediat online dhe duke krijuar një Regjistër të Mediave Online nën mbikëqyrjen e ASHMAA-së. Megjithatë, ekspertët argumentojnë se këto ndryshime janë të pamjaftueshme, nuk përputhen plotësisht me standardet evropiane si Akti Evropian për Lirinë e Medias (AVLM), dhe nuk trajtojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse çështje si pavarësia editoriale, mbrojtja ngaurvejimi apo përqendrimi i pronësisë në fushën digjitale³³. Kërkesa për një numër minimal punonjësish për regjistrim, megjithëse u rishikua pas kritikave, sërish ngre shqetësime mbi ndikimin që mund të ketë tek mediat e vogla, lokale dhe ato jofitimprurëse online.

Pritet që rregullorja dhe aktet mbështetëse të finalizohen dhe rregullimi të nisë zbatimin brenda vitit 2025, përpara zgjedhjeve lokale të tetorit.

³² DanilovskaBajdevska,D.(2024).DrejtZbatimittëQëndrueshëmtëAktitpërShërbimetDigjitalenëBallkanin Perëndimor: Përmbledhje – Maqedonia e Veriut. Partners for Democratic Change Serbia. https://metamorphosis.org.mk/en/izdanija_arhiva/towards-a-feasible-implementation-of-the-digital-services-act-in-the-western-balkans/

³³ Metamorphosis Foundation. (2025). Position Paper: Evaluating North Macedonia's Media Law Reforms - A Partial Step Toward European Standards. https://metamorphosis.org.mk/en/izdanija_arhiva/evaluating-north-macedonias-media-law-reforms-a-partial-step-toward-european-standards/

2.4 Reklamat shtetërore dhe rregullimi i fushatave zgjedhore

Legjislacioni në lidhje me financimin shtetëror dhe reklamat politike është tejet i diskutueshëm. Neni 102 i LSHMAAV-së më parë ndalonte reklamat shtetërore në mediat audiovizive private, një masë e vendosur në vitin 2017 për të kufizuar klientelizmin. Megjithatë, amendamentet e miratuara në vitin 2024 rikthyen fushatat me “interes publik” të financuara nga shteti, duke u lejuar autoriteteve shtetërore dhe lokale të alokojnë 0.1% të buxheteve të tyre për këtë qëllim³⁴. Ky hap u kritikua ashpër nga organizatat e medias dhe raporti i BE-së mbi Shtetin e së Drejtës si një kërcënim i mundshëm ndaj pavarësisë së medias dhe një rrezik për keqpërdorim politik, pavarësisht masave të propozuara si krijimi i një komisioni parlamentar bipartizan për përzgjedhjen e fushatave. Monitori i Pluralizmit të Medias 2024 nënvizon rreziqe të theksuara që lidhen me shpërndarjen e reklamave shtetërore, për shkak të abuzimeve të mëparshme dhe mundësisë për raste të reja klientelizmi.

Kodi Zgjedhor u lejon pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore të përdorin fonde nga buxheti shtetëror për reklama të paguara politike në televizione, media të shtypura dhe media online (Neni 76-e)³⁵. Ky model është unik për Maqedoninë e Veriut dhe është kritikuar për arsye të mëposhtme:

- Shtrembërim të tregut: Siguron burime domethënëse financiare, sidomos për partitë e mëdha dhe mediat e konsoliduara, me potencial për të krijuar varësi.
- Mungesë barazie: Mekanizmi i shpërndarjes favorizon partitë e mëdha parlamentare, duke krijuar disavantazh për partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur. Ky çekuilibër sistematik është vërejtur nga misionet e vëzhguesve ndërkombëtarë si ODIHR³⁶.
- Nxitje të mediave jo-profesionale online: Kjo dispozitë inkurajon krijimin e portaleve online kryesisht për të përfituar fonde nga reklamat zgjedhore, shpesh pa respektuar kritere transparence apo standarde profesionale.
- Potencial për korrupsion: Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) e ka identifikuar këtë model si bartës rreziku.

³⁴ Komisioni Evropian, (2024) Raporti i Shtetit të së Drejtës 2024: Kapitulli i vendit me situatë në shtetin të së drejtës në Maqedoninë e Veriut (SWD) (2024), 830 përfundimtare). https://commission.europa.eu/document/download/e7197a43-7f00-4eac-b02d-818ac71345f0_en?filename=61_1_58090_coun_chap_northmacedonia_nm.pdf

³⁵ Pepeljugoski, V., Manasiev, A., & Janevska, E. (2023). Të Drejtat e Gazetarëve, Liria e Shprehjes dhe Pavarësia e Medias në Maqedoninë e Veriut – 2023 Raporti Metadata. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2024/01/EN-MetaData-Report-131223-web.pdf>
Interview 1.

³⁶ OSBE, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Maqedonia e Veriut, Zgjedhjet Presidenciale dhe të Parakohshme Parlamentare, 24 prill dhe 8 maj 2024: Raporti Përfundimtar. <https://www.osce.org/odihr/elections/north-macedonia/576648>

2.5 Përputhshmëria me Standardet e BE-së dhe Reformat në zbatim

Maqedonia e Veriut ka nisur procesin e përafrimit të legjislacionit për mediat me acquis-në e BE-së, veçanërisht sa i përket Direktivës për Shërbimet Mediatike Audiovizive (DSHMA). Ndryshimet në LSHMAAV në vitin 2023 kishin për qëllim të çonin më tej këtë përafrim. Megjithatë, procesi më i gjerë i reformave, i cili përfshin hartimin e një Ligji të ri gjithëpërfshirës për Median - i cili raportohet se është hartuar me ndihmën e ekspertëve të BE-së, por nuk është propozuar nga qeveria) - si dhe përafrimin me Aktin Evropian për Lirinë e Medias (EMFA) dhe Akti për Shërbimet Digjitale (DSA), duket i fragmentuar dhe i ngadaltë.

Raporti (Position Paper) i Fondacionit Metamorfozis thekson se ndryshimet aktuale në Ligjin për Median harmonizohen vetëm pjesërisht me EMFA-n, duke qenë se mungojnë dispozita thelbësore mbi: vlerësimin e pluralizmit mediatik (Neni 22), të drejtat e gazetarëve dhe pavarësinë editoriale (Neni 6.3), si dhe mbrojtjen ngaurvejimi (Neni 4)³⁷. Është e pranuar gjerësisht nevoja për një qasje më gjithëpërfshirëse ligjore, për të siguruar koherencën e nevojshme ndërmjet ligjit për median, rregullimit digjital dhe masave kundër SLAPP.

³⁷Metamorphosis Foundation. (2025). Position Paper: Vlerësimi i Reformave të Ligjit për Mediat në Maqedoninë e Veriut – Një hap i pjesshëm drejt standardeve evropiane.
https://metamorphosis.org.mk/en/izdanija_arhiva/evaluating-north-macedonias-media-law-reforms-a-partial-step-toward-european-standards/

Seksioni 2 - Procesi i integrimi në BE

Sipas disa ekspertëve dhe profesionistëve të medias të intervistuar për këtë raport, procesi i integritimit në BE ka luajtur një rol relativisht të dobët në avancimin e standardeve të lirisë së medias në Maqedoninë e Veriut, siç dëshmohet nga përvoja zhgënjyese e procesit të reformës në fushën e mediave së vitit 2023³⁸. Siç shpjegoi njëri prej të intervistuarve: “pritëm që Komisioni Evropian të mbështeste pozicionin e ekipit të ekspertëve, por ata nuk ushtruan asnjë presion mbi ministrinë që të publikonte ndonjë analizë apo dokumentacion”³⁹.

Kjo pasqyron një problem më të gjerë: në momente kyçe, perceptimi është se Bashkimi Evropian nuk mban një qëndrim të qartë ose nuk ushtron presion ndaj autoriteteve kombëtare për të garantuar transparencë në hartimin dhe miratimin e ligjeve. Siç theksoi i njëjti bashkëbisedues, “nuk duan të mbajnë anë”, duke i lënë hapësirë qeverisë të ruajë një fasadë transparence, ndërkohë që ndjek një qasje formale dhe sipërfaqësore ndaj reformave.

Një intervistues tjetër shtoi se çështjet që lidhen me median duket sikur kanë më pak përparësi për zyrtarët e BE-së, krahasuar me tema të tjera më urgjente. Megjithatë, presioni ndërkombëtar mbetet thelbësor. Siç theksoi, “të huajt duhet të jenë më të zëshëm. Nëse reagimi vjen nga zëra ndërkombëtarë, ka më shumë peshë në nivel kombëtar”⁴⁰. Pa një mbështetje të tillë, aktorët vendas kanë ndikim të kufizuar.

Për më tepër, të intervistuarit për këtë raport shprehën pakënaqësi për faktin se progres raportet vjetore të Komisionit Evropian kanë përsëritur kryesisht të njëjtat vërejtje vitet e fundit, duke ua ulur kështu impaktin. Politikanët shpesh e përdorin faktin që gjendja e medias në Maqedoninë e Veriut nuk është aq e rëndë sa në disa vende të tjera kandidate apo madje edhe anëtare të BE-së, si një justifikim për të mos iu përgjigjur problemeve strukturore. Si rezultat, procesi i integritimit në BE ka ndikim të ulët: aktualisht nuk perceptohet si një nxitës i vërtetë i progresit. Edhe për çështje si kodi zgjedhor apo reklamat politike, BE-ja mund të përmendë shqetësime në raportet e saj, por rrallë herë ushtron presion domethënës. Siç e shprehu haptazi një nga të intervistuarit: “pse duhet të bëjmë reforma tani, kur gjithsesi nuk do të avancojmë”⁴¹?

³⁸ RESIS, BE-ja për Lirinë e Shprehjes – Punëtori mbi reformat mediatike në Maqedoninë e Veriut, 12–13 Tetor 2023. “Drejt një sektori mediatik të qëndrueshëm, të larmishëm dhe të sigurt: në mbështetje të demokracisë dhe pluralizmit dhe në shërbim të qytetarëve. https://www.resis.mk/images/Workshops_Summary_ENG.pdf

³⁹ Intervista 1.

⁴⁰ Intervista 4.

⁴¹ Intervista 6.

2.5.1 Legjislacioni i medias ne Maqedoninë e Veriut dhe Akti i Shërbimeve Digjitale i BE-së

Integrimi i Maqedonisë së Veriut në kuadrin rregullator digjital të BE-së përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të të drejtave digjitale dhe hapësirës online. Një dokument kyç në këtë proces është Akti për Shërbimet Digjitale (DSA), një kuadër evropian gjithëpërfshirës që synon të krijojë mjedise online më të sigurta, të garantojë transparencë dhe të mbrojë të drejtat themelore në hapësirën digjitale. Legjislacioni i medias në Maqedonisë së Veriut tani duhet të harmonizohet me standardet e BE-së, një proces me pasoja të rëndësishme për lirinë e medias, sigurinë digjitale dhe qartësinë rregullatore.

Kuadri ekzistues ofron një përputhje bazë me acquis të BE-së, duke u fokusuar kryesisht te rregullimi i përmbajtjeve dhe licencimi i transmetuesve. Megjithatë, ai nuk përmban dispozita të qarta për ndërmjetësit digjitalë, llogaridhënie për platformat shumë të mëdha online (VLOPs), dhe masa për adresimin e rreziqeve sistemike si disinformimi dhe gjuha e urrejtjes, elemente thelbësore të parashikuara nga Akti për Shërbimet Digjitale (DSA).

Një hap qendror është krijimi i rolit të Koordinatorit për Shërbimet Digjitale (KSHD), një autoritet kombëtar përgjegjës për mbikqyrjen, zbatimin dhe koordinimin në lidhje me rregullimin e shërbimeve digjitale.

Hulumtimet e fundit theksojnë se një harmonizim efikas duhet t'i japë përparësi transparencës në reklamimin online, mekanizmave për raportimin dhe heqjen e përmbajtjeve së paligjshme, si dhe mbrojtjes kundër praktikave abuzive të moderimit të përmbajtjeve. Maqedonia e Veriut duhet gjithashtu të garantojë procedura strikte për menaxhimin e rrezikut nga platformat shumë të mëdha online (VLOPs) që operojnë brenda juridiksionit të saj, duke u përshtatur me kërkesat e DSA-së. Ky proces kërkon ndryshime legjislative që të forcojnë llogaridhënien, transparencën dhe respektin për të drejtat themelore të përdoruesve në rrjet.

Një studim rajonal thekson nevojën për përfshirjen sa më të gjerë të aktorëve të ndryshëm, duke sugjeruar se organizatat e shoqërisë civile (OSHC) luajnë një rol thelbësor këshillues. Integrimi i OSHC-ve në kuadret rregullatore promovon besim, llogaridhënie dhe një qasje gjithëpërfshirëse ndaj qeverisjes digjitale, në përputhje me praktikat më të mira evropiane⁴².

⁴² Danilovska-Bajdevska, D., Ćeright, E., Culahovic, M., Reçi, M., Tosic, M., Nikcevic, S., & Sahatqija, T. (2024). Drejt Zbatimit të Qëndrueshëm të Aktit për Shërbimet Digjitale në Ballkanin Perëndimor: Partners for Democratic Change Serbia. https://metamorphosis.org.mk/en/izdaniya_arhiva/towards-a-feasible-implementation-of-the-digital-services-act-in-the-western-balkans/

Pavarësisht bazës legislative, Maqedonia e Veriut përballlet me disa sfida të ndryshme në zbatimin e reformave të lidhura me DSA-në. Gatishmëria institucionale është shqetësim parësor, sidomos në lidhje me ekspertizën teknike, kapacitetet dhe pavarësinë e figurave që mbajnë rolin e Koordinatorit për Shërbimet Digjitale (KSHD). Organet rregullatore, si Agjencia për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) dhe Agjencia për Komunikime Elektronike (AKE), janë kandidatë potencialë për të marrë rolin e KSHD-së. Megjithatë, nevojiten masa për zhvillimin e kapaciteteve të të dyja organeve për të menaxhuar në mënyrë efektive përgjegjësitë e shumta dhe të reja.

Më tej, mbetet një shqetësim i rëndësishëm ndikimi politik mbi autoritetet rregullatore. Për një harmonizim të suksesshëm me DSA-së, Maqedonia e Veriut duhet të garantojë pavarësi rregullatore, e mbrojtur përmes kuadrit legjislativ dhe financimit të përshtatshëm, duke reflektuar shqetësimet më të gjera të BE-së, të theksuara në Progres Raportet e rregullta të Komisionit Evropian.

Harmonizimi i legjislacionit mediatik të Maqedonisë së Veriut me Aktin e Shërbimeve Digjitale të BE-së përbën një pikë kyçe për qeverisjen digjitale dhe mbrojtjen e të drejtave themelore. Ndërsa kornizat legislative ekzistuese ofrojnë një përputhje bazë, reforma të konsiderueshme mbeten të nevojshme, veçanërisht për caktimin e një Koordinatori efikas për Shërbimet Digjitale dhe për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në proceset rregullatore. Adresimi i këtyre sfidave përmes investimeve specifike, mbrojtjeve të qarta ligjore dhe përfshirjes së gjerë të aktorëve do të pozicionojë qartazi Maqedoninë e Veriut brenda peizazhit të qeverisjes digjitale të BE-së, duke krijuar një mjedis digjital më të sigurt, më transparent dhe të bazuar në respektimin e të drejtave.

2.6 Mbrojtja e të Drejtave të Autorit

Ligji mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ngjashme (LDADN) siguron bazën ligjore për mbrojtjen e punës së gazetarëve dhe punonjësve të mediave. Përcakton gjithashtu autorësinë, bashkëautorësinë dhe të drejtat që lidhen me veprat e krijuara në kuadër të kontratave të punës ose komisioneve. Megjithatë, zbatimi i tij, veçanërisht në mjedisin digjital, mbetet sfidues. Problemet kryesore përfshijnë përdorimin e paautorizuar të përmbajtjeve ("gazetari copy-paste"), mungesën e njohurive nga gazetarët mbi të drejtat e tyre (p.sh. kompensimet për përdorime jashtë kushteve fillestare të punësimit), si dhe nevojën që organizatat e menaxhimit kolektiv të përfaqësojnë në mënyrë efikase interesat e gazetarëve.

Ligji mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ngjashme (LDADN) i është nënshtruar amendimeve për t'u harmonizuar me disa direktiva të BE-së (si direktiva 2019/790 për Tregun e Vetëm Digjital dhe 2019/789 për transmetimet online), të cilat synojnë të modernizojnë mbrojtjen, të përcaktojnë përgjegjshmërinë e ofruesve të shërbimeve online dhe të garantojnë pagesa të drejta për autorët.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve⁴³ në Ligjin mbi të Drejtat e Autorit, agregatori më i madh i lajmeve në vend, Time.mk, kërkoi zyrtarisht nga të gjitha faqet e listuara të nënshkruajnë një kontratë që t'i jepte licencën jo-ekskluzive, të parevokushme dhe pa pagesë për të mbledhur dhe përdorur përmbajtjet mediatike. Kërkesa nisi një debat të gjerë, që rezultoi me largimin nga agregatori i më shumë se 40 faqeve lajmesh, kryesisht profesionale dhe të përgjithshme. Aktualisht, po zhvillohen negociatat mes pronarit të agregatorit dhe faqeve të lajmeve për të gjetur një zgjidhje. Ky agregator lajmesh mbetet burimi kryesor i trafikut për të gjitha faqet e listuara, duke gjeneruar njëkohësisht të ardhura të konsiderueshme nga reklamat, pa prodhuar përmbajtje origjinale.

⁴³ Ligji për Ndryshimet dhe Plotësimet në Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ngjashme (2025), <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2025/05/%D0%98%D0%B7%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B8-%D0%B8-%D0%B4%D0%BE%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D0%97%D0%90%D0%9F%D0%A1%D0%9F-2025.pdf>

Rekomandime:

- Të sigurohet funksionimi efektiv i autoritetit rregullator të medias duke garantuar alokime buxhetore të rregullta dhe në kohë, si dhe duke zbatuar procedura transparente dhe mbi bazë merite për emërimin e anëtarëve të Këshillit. Këto emërimë duhet të bazohen në kritere të qarta dhe objektive, për të ruajtur pavarësinë, efikasitetin dhe paanshmërinë e institucionit.
- Të forcohet pozicioni i rregullatorit si organ i pavarur, duke rishikuar vendimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit dhe duke anuluar ndryshimet që kufizojnë kompetencat e tij vendimmarrëse në rinovimin e liçencave.
- Të ndërmerret një reformë gjithëpërfshirëse e Ligjit për Median, për t'iu përgjigjur panoramës së re mediatike, duke përfshirë hapësirën digjitale. Procesi i reformës duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje të gjerë, duke angazhuar të gjithë aktorët e interesuar, përfshirë shoqërinë civile, organizatat profesionale dhe ekspertët e medias. Ligji duhet të:
 - Garantojë transparencën e pronësisë së mediave tradicionale dhe digjitale/online
 - Sigurojë zbatimin e standardeve profesionale dhe etike të gazetarisë nga i gjithë sektori;
 - Harmonizojë kuadrin ligjor me Direktivën për Shërbimet Mediatike Audiovizive (DSHMA), Aktin Evropian për Lirinë e Medias (EMFA) dhe Aktin për Shërbimet Digjitale (DSA)
- Të forcohet kuadri rregullator digjital për ta përafëruar plotësisht me DSA-në, që të ketë në fokus:
 - Rregullimin e ndërmjetësve digjitalë dhe Platformave Shumë të Mëdha Online (VLOPs)
 - Menaxhimin e rreziqeve sistematike si disinformimi, gjuha e urrejtjes dhe reklamat online jo-transparente
 - Transparencën në moderimin e përmbajtjeve dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të përdoruesve.
 - Caktimin e një Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale (KSHD) për të mbikëqyrur zbatimin e rregullores, me mekanizma llogaridhënieje dhe garanci ligjore të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e tij dhe minimizuar ndërhyrjet politike.
 - Nxitjen e procese konsultuese të vazhdueshëm me pjesëmarrjen e OSHC-ve, përfaqësuesve të industrisë dhe akademisë, për të garantuar një qasje rregullatore të balancuar dhe gjithëpërfshirëse.
 - Investimin në programe të thelluara trajnimi për autoritetet rregullatore, në mënyrë që të jenë të përgatitura për të menaxhuar përgjegjësitë e reja lidhur me platformat digjitale.
 - Shfrytëzimin e mekanizmave rajonale ekzistuese për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni, duke promovuar standarde dhe praktika uniforme në të gjithë Ballkanin Perëndimor.
- Të sigurohet zbatimi efektiv i legjislacionit mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme, duke mbrojtur pronësinë intelektuale dhe interesat profesionale të gazetarëve dhe profesionistëve të medias.

3. Siguria e gazetarëve

3.1 Përmbledhje mbi sigurinë e mjedisit mediatik

Mjedisi i përgjithshëm për sigurinë e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut konsiderohet relativisht i sigurt krahasuar me disa vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, ndërsa sulmet fizike kanë shënuar rënie.

Raporti i Reporterëve pa Kufij (Reporters Without Borders) në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit 2025 për Maqedoninë e Veriut thekson se disa incidente kanë cënuar ndjenjën e sigurisë së gazetarëve, përfshirë sulme me zjarrvënie ndaj pronës së tyre dhe raste ngacmimesh nga policia. Nga njëra anë, u emëruan prokurorë të posaçëm për trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve, por nga ana tjetër, raporti shton se gazetarët që mbulojnë punën e prokurorëve përballen me presione të konsiderueshme⁴⁴.

Sipas regjistrimit të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), u regjistruan 7 sulme/kërcënime në vitin 2022, 5 në 2023 dhe 4 në 2024, një rënie nga shifrat shumë më të larta të viteve të mëparshme, por që sërish nxjerrin në pah rreze të vazhdueshme⁴⁵. Kërcënimet, intimidimet dhe forma të ndryshme presioni vazhdojnë, duke krijuar një klimë që mund të pengojë raportimin e lirë dhe kritik. Edhe pse sulmet e rënda fizike janë të rralla, gjithsesi janë regjistruar incidente të ndryshme, ndërsa ngacmimet online, veçanërisht drejtuar gazetarëve, janë një shqetësim në rritje. Statusi socio-ekonomik i pasigurtë i shumë gazetarëve e përkeqëson më tej situatën e sigurisë, duke theksuar rrezikun e vetëcensurës

⁴⁴ Reporterë pa Kufij 2025. Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit 2025. <https://rsf.org/en/country/north-macedonia>

⁴⁵ Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). Regjistri i rasteve të shkeljes së të drejtave të gazetarëve ndër vite. <https://znm.org.mk/povreda-na-novinari/>

3.2 Kërcenim fizike ose psikologjike

Kërcënimet fizike ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave, edhe pse më pak të shpeshta se më parë, vazhdojnë të ndodhin, veçanërisht ndaj personave që merren me gazetari hulumtuese ose që mbulojnë protesta dhe ngjarje me rrezik të lartë. Të tilla episode mund të përfshijnë shtyrje dhe pengim në kryerjen e punës, deri te dhuna fizike e drejtpërdrejtë që shkakton lëndime ose dëmtime të pajisjeve.

Sulmet psikologjike, përfshirë kërcënimet verbale me dhunë, intimidimin dhe shpifjet, po bëhen gjithnjë e më të zakonshme, sidomos online. Kërcënimet mund të jenë të drejtpërdrejta ("offline") ose të shpërndara përmes rrjeteve sociale, email-eve dhe platformave të tjera digjitale. Gazetarët gra janë më shumë të prekura nga gjuha e urrejtjes me bazë gjinore, seksizmi dhe mizogjinia, ndërsa kërcënimet online janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Sulme të tilla mund të shkaktojnë frikë, ankth dhe trauma psikologjike, duke ndikuar në mirëqenien e gazetarëve dhe aftësinë e tyre për të punuar⁴⁶.

3.3 Ngacmimet online dhe siguria digjitale

Hapësira digjitale është bërë arena kryesore e kërcënimeve ndaj gazetarëve. Ngacmimet online përfshijnë gjuhë urrejtjeje, kërcënime me dhunë, përndjekje, shpërndarje disinformacioni për gazetarët dhe përpjekje për të diskredituar punën e tyre. Anonimiteti që ofrojnë disa platforma online mund të inkurajojë sulmuesit. Gazetarët kanë nevojë për njohuri dhe mjete të përshtatshme për sigurinë digjitale, për të mbrojtur veten, burimet dhe të dhënat e tyre. Redaksitë dhe shoqatat profesionale kanë rolin e tyre në ofrimin e mbështetjes dhe trajnimeve për sigurinë digjitale⁴⁷. Ministria e Brendshme ka ngritur një Departament të posaçëm për Krimet Kibernetike (DKK) dhe ka emëruar një oficer ndërlidhës për të trajtuar kërcënimet digjitale ndaj gazetarëve⁴⁸. Megjithatë, pavarësisht këtyre mekanizmave, treguesi për mbrojtje efektive ndaj ngacmimeve online shënoi vetëm një përmirësim të vogël në vitin 2023 (me vlerësimin 3.51 krahasuar me 3.46 në vitin 2022), duke treguar se sfidat vazhdojnë të jenë të pranishme⁴⁹.

⁴⁶ Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). Regjistri i rasteve të shkeljes së të drejtave të gazetarëve ndër vite. <https://znm.org.mk/povreda-na-novinari/>

⁴⁷ Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). (2024). Udhëzues për Sigurinë e Gazetarëve. https://znm.org.mk/%C3%ABp-content/uploads/2024/08/ENG_ZNM_Priracnik-za-bezbednost-na-novinari-FINAL.pdf

⁴⁸ Komisioni Evropian (2024). Raporti i Shtetit të së Drejtës 2024: Kapitulli mbi situatën e shtetit të së drejtës në Maqedoninë e Veriut (SWD) (2024) https://commission.europa.eu/document/download/e7197a43-7f00-4eac-b02d-818ac71345f0_en?filename=61_1_58090_coun_chap_northmacedonia_nm.pdf

⁴⁹ Spirovski, M. (2024). Maqedonia e Veriut – Treguesit për Nivelin e Lirisë së Medias dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2023. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. https://znm.org.mk/ep-content/uploads/2024/11/MK-ENG-2024_FINAL-1.pdf

3.4 Korniza ligjore dhe përgjigjja institucionale

Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për përmirësimin e mbrojtjes ligjore të gazetarëve. Ndryshimet në **Kodit Penal** të shkurtit 2023 përbëjnë një zhvillim kyç:

- **Sulmet e barazuara me ato të zyrtarëve:** Sulmet ndaj gazetarëve gjatë ushtrimit të detyrës trajtohen tashmë në mënyrë të ngjashme me sulmet ndaj zyrtarëve (për shembull oficerë policie, gjyqtarë), duke i lejuar Prokurorisë Publike (PP) të ndjekë çështjet penalisht “ex officio”. Kjo vlen për veprat e kryera ndaj një gazetari i cili përkufizohet si “person që kryen profesionalisht funksione, detyra ose punë me interes publik ose të përgjithshëm”⁵⁰.
- **Vepra të veçanta penale:** është specifikuar më tej natyra e krimeve, shoqëruar me dënime më të rrepta për krime si vrasja (Neni 123), detyrimi (Neni 139), kërcënimi për sigurinë (Neni 144) dhe pengimi i një funksionari në kryerjen e veprimtarive zyrtare (Neni 382) kur kryhen ndaj një gazetari
- **Përndjekja:** Kriminalizimi i përndjekjes (stalking) (Neni 144a), përfshirë format online, ofron një mekanizëm plotësues mbrojtjeje, veçanërisht duke pasur parasysh përhapjen e ngacmimeve online.
- **Vepra të tjera të rëndësishme:** Edhe pse nuk mbrojnë specifikisht gazetarët si zyrtarë, artikuj të tjerë si Lëndimi në trup (Neni 130/131), Kërcënim me armë të rrezikshme (Neni 133), Dhunë (Neni 386) dhe Nxitje e urrejtjes kombëtare/racore/fetare (Neni 319) mund të zbatohen në rastet kur viktimat janë gazetarë.

Ligji i Përgjegjësisë Civile për Fyerje dhe Shpifje (LPCFSH) u ndryshua në fund të vitit 2022. Përpos dekriminalizimit të shpifjes dhe fyerjes, ndryshimi uli ndjeshëm shumë maksimume që mund të paguhet për dëmet jo-pasurore në raste gjykimi për shpifjeje të humbura nga gazetarët ose mediat (në €400 për gazetarët, €2000 për botuesit, €5000 për personat juridikë)⁵¹. Qëllimi është të kufizohet efekti frenues (chilling) i padive që mund të kenë pasoja të rënda për media. është regjistruar përmirësim edhe në reagimin e institucioneve.

- **Prokurorë të posaçëm:** Janë emëruar prokurorë të posaçëm në Shkup dhe në tre rajone të tjera (Bitola, Tetovë, Shtip) për të koordinuar dhe monitoruar çështjet që lidhen me sigurinë e gazetarëve, duke lehtësuar komunikimin dhe ndjekjen e procedimeve.

⁵⁰ Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). (2024). Udhëzues për Sigurinë e Gazetarëve, fq. 21-22, citim nga Neni 122(9) i Kodit Penal.

⁵¹ Alexov, Z., & Hadji-Zafirova, Z. (2023). ANALIZË – Si mund të garantohet mbrojtje më efektive nga paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPPs)? Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, UNESCO GMDF. https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2024/02/ENG_Analiza-SLAPP-02-12-1.pdf

- **Ministria e Brendshme (MB):** Bashkëpunimi mes MB-së dhe Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) është formalizuar përmes Memorandumeve dhe Protokolleve (si për shembull Protokoli për Sigurinë Online të Gazetarëve), me synim për të pasur reagime më të shpejta ndaj kërcënimeve. Departamenti për Kontroll të Brendshëm, Hetime Penale dhe Standardet Profesionale (DKBHPSP) trajton ankesat ndaj oficerëve të policisë.
- **Mekanizmat e raportimit:** Gazetarët mund të raportojnë kërcënime pranë policisë lokale, Departamentit për Krime Kibernetike të BM-së (cybercrime@moi.gov.mk), ose pranë Prokuroria përkatëse (PP). Raportimi i hershëm dhe dokumentimi (screenshot- e, URL) është thelbësor.

Përkundër përparimeve, sfidat mbeten. Hetimet dhe procedimet gjyqësore shpesh janë të ngadalta, dhe pandëshkueshmëria për sulmet e së kaluarës vazhdon, pasi më pak se 10% e shkeljeve të regjistruara nga SHGM gjatë pesë viteve të fundit kanë përfunduar me zgjidhje në gjykatë⁵². Efektiviteti i dispozitave të reja ligjore mbetet i kushtëzuar nga zbatimi i qëndrueshëm nga policia, prokuroria dhe gjykatat.

3.5 Kushtet e punës dhe presionet ekonomike

Gjendja e pasigurisë socio-ekonomike e gazetarëve është e lidhur ngushtë me sigurinë dhe pavarësinë e tyre. Vështirësitë kryesore përfshijnë:

- **Pagat e ulëta:** Shpesh nën mesataren kombëtare, të cilat i bëjnë gazetarët financiarisht të cenueshëm. Më shumë se gjysma (55%) kanë paga më të ulëta se mesatarja⁵³.
- **Kontratat e pasigurta:** Përdorimi i përhapur i kontratave me afat të caktuar, i punës së pavarur, apo edhe mungesa e kontratave, sidomos në median online⁵⁴.
- **Kushtet e vështira të punës:** Janë të shpeshta vështirësitë si oraret e zgjatura (28% punojnë më shumë se sa lejon ligji), orët shtesë të papaguara, mungesa e benefiteve (si sigurimi për lëndime), mosrespektimi i të drejtave të punës (p.sh., e drejta për leje, ditë pushimi) si dhe nivele të larta stresi (55% janë shpesh të ekspozuar ndaj stresit)⁵⁵.
- **Ngacmimi në vendin e punës:** Përfshirë raste mobbing-u dhe ngacmimi me bazë gjinore, që kontribuojnë në stres dhe mbingarkesë profesionale (burnout)⁵⁶.

⁵² Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). (2023). Liria e medias në Maqedoninë e Veriut: Përparim i brishtë – Raport i Misionit të Verifikimit të Fakteve mbi Lirinë e Shtypit. fq. 9.

⁵³ "Statusi profesional dhe të drejtat e punës së gazetarëve dhe punonjësve të medias", SSNM; RESIS, Mars 2024 <https://resis.mk/images/about-us/PDF/working-conditions-in-the-media-sector.pdf>

⁵⁴ "Statusi profesional dhe të drejtat e punës së gazetarëve dhe punonjësve të medias" SSNM; RESIS, Mars 2024 <https://resis.mk/images/about-us/PDF/working-conditions-in-the-media-sector.pdf>

⁵⁵ Statusi profesional dhe të drejtat e punës së gazetarëve dhe punonjësve të medias", SSNM; RESIS, Mars 2024 <https://resis.mk/images/about-us/PDF/working-conditions-in-the-media-sector.pdf>

⁵⁶ Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). (2024). Udhëzues për Sigurinë e Gazetarëve. https://znm.org.mk/ep-content/uploads/2024/08/ENG_ZNM_Priracnik-za-bezbednost-na-novinari-FINAL.pdf

Këto kushte i bëjnë gazetarët më të ndjeshëm ndaj presionit nga pronarët, politikanët dhe interesat e biznesit, duke nxitur vetëcensurën dhe duke minuar standardet etike. Mungesa e marrëveshjeve kolektive në sektorin e mediave private pengon përpjekjet për përmirësimin e të drejtave të punës⁵⁷.

3.6 Padi të Strategjike Kunder Pjesëmarrjes Publike (SLAPPs)

Padi të SLAPP përfaqësojnë një kërcënim të rëndësishëm ligjor, veçanërisht për gazetarët investigativë dhe mediat kritike ndaj subjekteve me pushtet. Ato përbëjnë një formë rreziku ligjor që ndikon në sigurinë dhe lirinë e gazetarëve.

SLAPP-et janë padi të ngritura jo detyrimisht për të kërkuar drejtësi ose kompensim për një ankesë legjitime, por më së shumti për të frikësuar, heshtur, ngacmuar dhe rënduar financiarisht kritikët (gazetarë, aktivistë, OJQ) që shprehen mbi çështje me interes publik.

Edhe pse Maqedonia e Veriut nuk ka legjislacion të posaçëm kundër padive SLAPP, fenomeni ekziston dhe njihet si sfidë. Padi të për shpifje janë mjeti më i zakonshëm⁵⁸. Ndryshimet e vitit 2022 në Ligjin për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje (LPCFSH) reduktuan masat e dëmshpërblimeve, duke zbutur potencialisht një aspekt të padive SLAPP, por gjithsesi ato nuk ofrojnë garanci procedurale specifike si për shembull mekanizmat e rrëzimit të hershëm të padive. MPM 2024 e vlerëson rrezikun që lidhet me padi të SLAPP si të lartë, duke theksuar mungesën e legjislacionit të posaçëm anti-SLAPP⁵⁹.

Përhapja: edhe pse shifrat e sakta janë të vështirë për t'u gjurmuar për shkak të mungesës së identifikimit specifik, analizat sugjerojnë një rritje shqetësuese të padive. Pas disa viteve rënie, rastet e shpifjes kundër gazetarëve/mediave u rritën në 54 në vitin 2022, përpara se të binin sërish në 19 raste aktive deri në fund të vitit 2023. AGSH regjistroi gjashtë raste që mund të klasifikohen si padi SLAPP në vitin 2023.

⁵⁷ Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (2023). Liria e medias në Maqedoninë e Veriut: Progres i brishtë – Raporti i Misionit të Verifikimit të Fakteve mbi Lirinë e Medias. <https://ëëë.ecpmf.eu/ëp-content/uploads/2023/11/EN-Fact-Finding-PFM-Report-251023-ëëb-1.pdf>

⁵⁸ Alexov, Z., & Hadji-Zafirova, Z. (2023). ANALYSIS - Hoë to ensure more effective protection from strategic lawsuits against public participation (SLAPPS)? Association of Journalists of Macedonia, UNESCO GMDF. https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2024/02/ENG_Analiza-SLAPP-02-12-1.pdf

⁵⁹ Micevski, I., & Trpevska, S. (2024, qershor). Micevski, I., & Trpevska, S. (2024, June). Monitorimi i Pluralizmit Mediatik në Epokën Digjitale: Zbatimi i Monitorit të Pluralizmit të Mediave në Shtetet Anëtare të BE-së dhe Vendet kandidatë për vitin 2023 – Raporti i Vendi: Republika e Maqedonisë së Veriut. European University Institute, Qendra për Pluralizëm Mediatik dhe Liri të Medias <https://cadmus.eui.eu/server/api/core/bitstreams/ed9fd83e-1455-5e49-b698-ae3bf0999e2a/content>

- Avokatët dhe gazetarët raportojnë se përballen me padi nga zyrtarë publikë dhe figura biznesi me synimin për të penguar punën investiguese, duke përmendur shembuj si rastet kundër Investigative Reporting Lab (IRL)⁶⁰. Treguesi që mat nëse ligjet për shpifje krijojnë efekt frenues për gazetarinë u përkeqësua lehtë në vitin 2023 (në vlerën 4.22 krahasuar me 4.34 në 2022), pjesërisht për shkak të vendimeve gjyqësore shqetësuese si ai kundër IRL⁶¹.
- **Kuadri Ligjor:** Mbrojtja aktualisht mbështetet në dispozita të përgjithshme të Ligji i Përgjegjësisë Civile për Fyerje dhe Shpifje (LPCFSH) (përgjashtime për përgjegjësinë për shpifje/fyerje, në veçanti kur bëhet fjalë për çështje me interes publik dhe figura publike), në Ligjin për Procedurën Civile (mundësi për shqyrtimin e interesit juridik, sado i kufizuar), si dhe në zbatimin e parimeve të nenit 10 të KEDNJ. Fondacioni Metamorfozis thekson mungesën e dispozitave specifike kundër padive SLAPP në propozimet e fundit për reformën e ligjit për median⁶².
- **Impakti:** Paditë SLAPP dëmtojnë burimet financiare (shpenzime gjyqësore), konsumojnë kohë, shkaktojnë stres të rëndë psikologjik dhe mund të çojnë në vetëcensurë⁶³.

⁶⁰Një vendimi njohur për shpifje, i cilësuar si rast SLAPP, u regjistrua në lidhje me gazetarët investigativë të një organizate mediatiqe jo-fitimprurëse. Shih: Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (2023), Alexov, Z., & Hadji-Zafirova, Z. (2023). ANALIZË—Simundtëgarantohetmbrojtjemëefektivengapaditëstrategjikekundër pjesëmarrjes publike (SLAPPs)?, Monitori i Pluralizmit të Medias 2024, Raporti i vendit për Maqedoninë e Veriut, Media Freedom Rapid Response (2023); Gjykatësi rekomandon mbylljen e medias hulumtuese Investigative Reporting Laboratory (IRL), si dhe Media Freedom Rapid Response (2023); Gjykatësja Jovanka Spirovska Paneva vendos kundër IRL-së në çështje shpifjeje.

⁶¹Spirovski, M. (2024). Maqedonia e Veriut – Treguesit për Nivelin e Lirisë së Medias dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2023. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. fs. 45.

⁶²Evaluating North Macedonia's Media Law Reforms—A Partial Step Toward European Standards 2025. Metamorphosis Foundation <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/themes/metamorphosis/download.php?id=45569>

⁶³Alexov, Z., & Hadji-Zafirova, Z. (2023). ANALYSIS - How to ensure more effective protection from strategic lawsuits against public participation (SLAPPs)? Association of Journalists of Macedonia, UNESCO GMDF. https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2024/02/ENG_Analiza-SLAPP-02-12-1.pdf

Rekomandime:

- Të përmiresohet mbrojtja dhe kushtet e punës për gazetarët:
 - Të njihen ngacmimet online, përfshirë intimidimet verbale dhe fushatat denigruese në platformat digjitale si kërcënime serioze për lirinë e shtypit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore dhe ngacmimeve që synojnë gazetarët gra.
 - Të sigurohen mjete efikase për mbrojtjen e gazetarëve, burimeve dhe të dhënave të tyre, veçanërisht në mjedisin digjital, duke fuqizuar rolin e Departamentit për Krimet Kibernetike (DKK) si dhe të oficerit ndërlidhës, për të mbështetur gazetarët që përballen me kërcënime digjitale
 - Të nxitet bashkëpunim më i ngushtë midis organeve të zbatimit të ligjit, shoqatave profesionale dhe redaksive të mediave për të garantuar përgjigje të shpejta ndaj kërcënimeve dhe ngacmimeve.
 - Të sigurohet zbatimi efikas i mbrojtjeve ligjore për gazetarët dhe profesionistët e mediave nga autoritetet ligjzbatuese dhe të përmirësohet hetimi dhe ndjekja penale e krimeve kundër gazetarëve për të thyer ciklin e pandëshkueshmërisë.
 - Të promovohen marrëveshje kolektive në sektorin e mediave private për të garantuar kushte të përshtatshme pune, përmirësimin e pagave, të sigurisë kontraktuale, dhe vendosjen e pagave minimale.
 - Të rregullohen platformat digjitale dhe mediat online për të garantuar që këto të respektojnë të njëjtat standarde pune si mediat tradicionale.
- Të miratohet legjislacion specifik kundër padive SLAPP, i harmonizuar me standardet e BE-së, në veçanti me direktivën anti-SLAPP të BE-së dhe rekomandimet e saj, si dhe me rekomandimet e Këshillit të Evropës
- Të përmirësohet monitorimi dhe mbledhja e të dhënave mbi paditë SLAPP dhe kërcënimet e tjera ligjore ndaj gazetarëve, dhe të sigurohet ndjekja e duhur dhe në kohë nga autoritetet kompetente e rasteve që përfshijnë veprime ligjore abuzive.

4. Disinformimi dhe ndikimi i huaj

4.1 Panoramë e disinformimit

Disinformimi paraqet një kërcënim domethënës për mjedisin mediatik dhe proceset demokratike në Maqedoninë e Veriut. Shpesh është i lidhur me polarizimin politik, tensionet etnike dhe ndikimet e jashtme, duke kontribuar në një shoqëri thellësisht të përçarë, me besim të ulët në institucione dhe media. Sfera online, e cila në masë të madhe është e pa rregulluar, veçanërisht platformat e mediave sociale dhe shumë portale lajmesh kryesisht të fragmentuara dhe të ndara ideologjikisht, që operojnë me standarde të ulëta profesionale dhe pak transparencë, shërben si një terren i favorshëm për përhapjen e shpejtë të narrativave të rreme. Gara për të botuar i pari një lajm dhe për të marrë sa më shumë vizita në faqe, bën të mundur që narrativat disinformuese të hyjnë në hapësirën kryesore të informacionit. Kjo dobësi thellohet edhe nga mungesa e mekanizmave për të luftuar në mënyrë efektive gjuhën e urrejtjes, lajmet e rreme dhe disinformimin në platformat online, përveç disa përpjekjeve për vetë-rregullim dhe verifikim të fakteve në Facebook.

Aktori kryesor në luftën ndaj Manipulimit të Informacionit nga Aktorë të Huaj (MIAH) dhe Interferencat është sektori i shoqërisë civile. Nën drejtimin e Fondacionit Metamorfozis, disa organizata të shoqërisë civile kanë nisur një iniciativë për të nxitur një qasje më strategjike në luftimin e MIAH dhe kanë hartuar një seri rekomandimesh për të gjithë aktorët relevantë në vend⁶⁴. Edhe pse qeveria e mëparshme i pranoi formalisht rekomandimet dhe deklaroi se është e gatshme të punojë për krijimin e një strategjie për të luftuar Manipulimin e Informacionit nga Aktorë të Huaj, nuk është bërë shumë. Që nga vera e vitit 2024, qeveria e re duket se është edhe më pak e interesuar për këtë çështje. Megjithatë, programi zyrtar përfshinte disa referenca për adresimin e disinformimit si një nga synimet e qeverisë.

⁶⁴Fondacioni Metamorfozis (2023) Rekomandime për Veprim të Përbashkët për Ndërtimin e Rezistencës Shoqërore ndaj Ndikimeve të Dëmshme të Dezinformimit https://metamorphosis.org.mk/en/izdanija_arhiva/recommendations-for-joint-action-for-building-societal-resilience-towards-malign-influences-of-disinformation/

4.2 Narrativat kryesore and Manipulimi i Informacionit nga Aktorë të Huaj (MIAH)

Narrativat disinformuese që përhapen në Maqedoninë e Veriut nuk kufizohen vetëm te çështjet e brendshme, por përfshijnë një gamë të gjerë temash si lufta në Ukrainë, konflikti në Lindjen e Mesme, narrativat kundër vaksinimit, çështjet gjinore, LGBTQ+ si dhe teori konspirative të njohura. Pra është i pranishëm i gjithë spektri.

Disa nga narrativat e përhapura së fundmi lidhen me:

- **Integrimin në BE dhe identitetin kombëtar:** Fushatat disinformuese shpesh e paraqesin integrimin në BE si një kërcënim për identitetin kombëtar, gjuhën dhe kulturën maqedonase, duke u fokusuar veçanërisht te mosmarrëveshjet historike me vendet fqinje si Bullgaria dhe Greqia. Kërkesa për përfshirjen e minoritetit bullgar në Kushtetutë si kusht për avancimin e negociatave me BE-në është një pikë e nxehtë, e cila shfrytëzohet për të nxitur mosbesim ndaj BE-së dhe për të ushqyer ndjenja nacionaliste.
- **Marrëdhëniet ndëretnike:** Taktikat e disinformimit shpesh synojnë të minojnë Marrëveshjen Kornizë të Ohrit – e cila i dha fund konfliktit të vitit 2001 – dhe të theksojë tensionet mes maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë. Narrativat sugjerojnë se shqiptarët përfitojnë në mënyrë disproporcionale nga integrimi në BE në dëm të maqedonasve, duke vënë kështu në rrezik stabilitetin. Qasje anti-shqiptar janë vërejtur në fushata politike të nxitura nga parti haptazi pro-ruse. Në zgjedhjet e ardhshme vendore, pritet që narrativat të tilla ndëretnike të përdoren sërish.
- **Lëvizjet kundër vaksinimit:** Narrativat kundër vaksinimit janë përhapur gjerësisht nëpër rrjete sociale dhe disa media, duke nxitur mosbesim ndaj vaksinave dhe institucioneve shëndetësore, veçanërisht gjatë pandemisë së COVID-19. Edhe pse këto pretendime janë përgënjeshtuar, sërish vazhdojnë të tërheqin vëmendje, përfshirë ato që pretendojnë se vaksinat ndryshojnë ADN-në ose përmbajnë mikroçipe. Këto narrativa kanë çuar në uljen e besimit publik ndaj fushatave të imunizimit, duke kontribuar në rikthimin e sëmundjeve si kolla e mirë, i cili më parë ishte thuhet i zhdukur.
- **Lëvizjet kundër politikave gjinore:** Narrativat kundër politikave gjinore kanë fituar vizibilitet në diskursin publik të vendit. Mediat kryesore shpesh amplifikojnë mesazhe nga organizata konservatore dhe fetare pa ushtruar një qasje kritike, duke kontribuar kështu në përhapjen e infomacioneve të rreme lidhur me barazinë gjinore. Këto narrativa shpesh lidhen me frikën e humbjes së vlerave tradicionale familjare dhe përdoren për të mobilizuar kundërshtimin ndaj legjislacionit që mbron barazinë gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBTQ+.

4.3 Aktorët dhe kanalet

Disinformacioni përhapet përmes kanaleve të ndryshme:

- **Media online:** Shumë media operojnë me standarde të ulëta profesionale dhe mungesë transparence, duke ripublikuar lehtësisht përmbajtje të paverifikuara ose narrativa të njëanshme, shpesh të përkthyer nga burime serbe ose ruse.
- **Rrjetet sociale:** Platforma si Facebook, X, TikTok dhe YouTube janë kanalet kryesore për përhapjen e disinformimit, gjuhës së urrejtjes dhe fushatave të ndikimi të koordinuara, të cilat shpesh përforcohen nga llogari të rreme ose të kontrolluara nga bot-e. Rregullimi dhe moderimi i përmbajtjes është i dobët, me përjashtim të platformave Facebook/Instagram (të cilat kanë mekanizma të verifikimit të fakteve nga palë të treta).
- **Aktorët politikë:** Disa parti dhe figura politike vendase përdorin retorikë nacionaliste, populiste ose përçarëse, e cila përputhet me ose amplifikon narrativat disinformuese, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore.
- **Ambasadat e huaja dhe mediat e kontrolluara nga shteti:** Ambasada ruse është veçanërisht aktive në rrjetet sociale, ndërsa mediat shtetërore ruse (si Sputnik dhe RT në gjuhën serbe) shërbejnë si burim për mediat vendase.
- **Influencuesit vendas:** Disa komentues dhe influencers online kontribuojnë në përhapjen e përmbajtjeve polarizuese ose mashtruese.

4.4 Përgjigjja institucionale dhe sfidat

Përgjigjja institucionale ndaj disinformimit dhe MIAH ka qenë e ngadaltë dhe e fragmentuar:

- **Nismat qeveritare:** Edhe pse në vitin 2019 u propozua një "Plan për Veprim të Vendosur Kundër Përhapjes së Disinformimit" dhe se ekziston një "Strategji për Ndërtimin e Rezistencës dhe Trajtimin e Kërcënimeve Hibride (2021-2025)", zbatimi i tyre ka qenë i kufizuar dhe pa përfshirje të gjerë. Në vitin 2023 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi me SHBA-të për të luftuar disinformimin, por statusi i zbatimit nën qeverinë e re mbetet i paqartë. Programi aktual qeveritar përmend një "luftë efektive kundër disinformimit", por mungojnë masa specifike.
- **Mosveprimi parlamentar:** Kuvendi ka qenë kryesisht jofunksional në këtë drejtim, pa një komision të veçantë të ngarkuar në mënyrë specifike për mbikëqyrjen e politikave kundër MIAH ose disinformimit, edhe pse disa komisione kanë portofole domethënëse.
- **Legjislacioni:** Nuk ekziston një legjislacion specifik që të adresojë rolin e MIAH ose disinformimit në mënyrë gjithëpërfshirëse. Ligjet aktuale për mediat ((LSHMAAV), LM) kanë një fushë të kufizuar, veçanërisht në sektorin online. Përshtatja me Aktin për Shërbimet Digjitale të BE-së (DSA), i cili përfshin masa kundër disinformimit në platformat e mëdha, është ende e pazbatuar dhe përballet me sfida në kapacitetin institucional.
- **Udhëheqja e Shoqërisë Civile:** Organizata të shoqërisë civile, si Fondacioni Metamorfozis, kanë qenë në vijën e parë, duke kryer verifikime faktesh, hulumtime, projekte për edukimin mediatik si dhe duke advokuar për një qasje sistemike që përfshin të gjithë shoqërinë. Rekomandimet e hartuara përmes proceseve gjithëpërfshirëse i janë paraqitur qeverisë.

4.5 Siguria kibernetike dhe kërcënimet e ardhshme

Siguria kibernetike mbetet një sfidë e rëndësishme, pasi strategjia kombëtare konsiderohet e nënzhvilluar dhe mungon fokusimi te kërcënimet e reja, si Inteligjenca Artificiale (IA)⁶⁵. Edhe pse lajmet disinformuese tejet të sofistikuara të gjeneruara nga IA (p.sh. deep fakes që targetojnë figura vendore) ende nuk janë përhapur gjerësisht – kryesisht për shkak të kufizimeve gjuhësore dhe të të dhënave – ekziston potenciali për shfrytëzim në të ardhmen, krahas zhvillimit të teknologjisë. Cenueshmëria e vendit ndaj sulmeve kibernetike e përkeqëson më tej rrezikun e manipulimit të informacionit.

⁶⁵ Trojchanec, M. & Rizaov, G. (shtator 2024). Stabiliteti nën kërcënim: MNHI në Maqedoninë e Veriut. Metamorphosis Foundation, IRI Beacon Project, fq. 14.

RECOMMENDATIONS:

- Të vendosen sisteme efikase për të luftuar gjuhën e urrejtjes, lajmet e rreme dhe disinformimin në platformat online, përfshirë zhvillimin e praktikave të përshtatshme dhe transparente të moderimit të përmbajtjes.
- Të zbatohet legjislacion specifik kundër Manipulimit të Informacionit dhe Ndërhyrjeve të Huaja (MNHI) dhe disinformimit, në përputhje me standardet e BE-së, si për shembull Akti për Shërbimet Digjitale (DSA)
- Të promovohet bashkëpunim i strukturuar me shoqërinë civile për të hartuar një përgjigje strategjike dhe gjithëpërfshirëse ndaj disinformimit.
- Të garantohet zbatimi efektiv i nismave aktuale, përfshirë Planin për Veprim të Vendosur Kundër Përhapjes së Disinformimit dhe "Strategjinë për Ndërtimin e Rezistencës dhe Trajtimin e Kërcënimeve Hibride (2021-2025).
- Të përditësohet dhe zgjerohet strategjia kombëtare për sigurinë kibernetike, në mënyrë që të pasqyrojë ndryshimet shoqërore dhe rreziqet e reja, përfshirë ato të lidhura me Inteligjencën Artificiale dhe rolin e saj të mundshëm në përhapjen e disinformimit.

Lista e Intervistave:

- Instituti për Kërkime për Zhvillimin Social - RESIS
- Qendra për Zhvillimin e Medias
- Instituti Maqedonas për Media
- Eurothink
- Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGA)
- Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SPGPM)

Ekipi kërkimor:

- Goran Rizaov, Fondacioni Metamorfozis
- Zoran Richliev, Fondacioni Metamorfozis
- Serena Epis, Osservatorio Balcani Caucaso Transeuropa



Ministero degli Affari Esteri
e della Cooperazione Internazionale

 **MEDIA FREEDOM
RAPID RESPONSE**

co-funded by



Ky projekt bashkëfinancohet nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar. Përmbajtja e këtij dokumenti pasqyron vetëm pikëpamjet e autorëve dhe në asnjë rast nuk përfaqëson qëndrimin e Ministrisë Italiane e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar.

Projekti është bashkëfinancuar gjithashtu nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë ekskluzivisht të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian, as autoriteti financues nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e tij.